



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”” (*Komisioni përgjegjës*)

2. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar” (*Komisioni përgjegjës*)

3. Shqyrtimi nen për nen dhe votimi i projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019”, dhe paketës fiskale (*Komisioni për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglangtina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Dritan Bici dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit

Pëllumb Abeshi – Drejtor në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit

Vilma Kola – Drejtoreshë në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit

Rovena Agalliu – Specialiste në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit

Elvin Lako – Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Rudina Bollano - Drejtoreshë e Ekzaminimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Lindita Mëneri - Përgjegjëse e Sektorit të markave, dizenjove dhe treguesve gjeografikë

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Aurora Alimadhi - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Irfan Tarelli - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

Enea Hoti - Drejtor i Përgjithshëm i Rregullatores dhe Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural

Agron Vata - Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Niko Lera – Përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuçi – Përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Jonida Kaza – Përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Doriana Toro – Përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Arben Krasniqi – Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Benet Fociro – Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje!

Në vijim të agjendës së kësaj jave, sot kemi parashikuar diskutimin e dy projektligjeve, si dhe diskutimin final për paketën fiskale, për të cilën besoj se jemi gati me të gjitha propozimet dhe konkluzionet tona mbas diskutimeve intensive me grupet e interesit.

Jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Projektligjet e ditës së sotme janë: projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës, për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”, si dhe projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

E fillojmë me projektligjin e dytë të rendit të ditës.

Të ftuar kemi (këtu kam edhe emrin e Ornelës, por Ornelën nuk po e shoh) zotin Pëllumb Abeshi, drejtor, zonjën Vilma Kola dhe zonjën Roven Agalliu, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Relator është zoti Baraj.

Pastaj do të vijojmë me diskutimin e projektligjit tjetër.

Zoti relator, t’ua japim fjalën përfaqësuesve të ministrive dhe më pas, nëse ka pyetje...

Dakord. Fjala për ju.

Pëllumb Abeshi – Faleminderit!

Propozimi i këtij projektligji për amendimin e protokollit të Montrealit vjen si rezultat i një procesi në vazhdimësi të bashkëpunimit të Republikës së Shqipërisë dhe detyrimeve që ajo merr në kuadër të këtij protokollit.

Konkretisht, bëhet fjalë për rishikimin e listës së gazeve me efekt serrë.

Ky protokoll është nënshkruar në vitin ’99 dhe konsiderohet si protokoll i suksesshëm, me rezultate konkrete të arritura në drejtimin e realizimit të objektivave.

Nisur nga kjo, si dhe nga analiza e kësaj situate, është bërë vlerësimi i një grupi tjetër kimikatesh, të cilat shërbejnë si gaze me efekt serrë për hollimin e shtresës së ozonit. Mbi këtë bazë është marrë vendimi në Kigal, që një grupi të caktuar të këtyre kimikateve t’i ndalohet prodhimi, importi dhe eksporti.

Shqipëria, duke qenë se është palë në protokollin e Montrealit, ka detyrimin ta implementojë atë në legjislacionin kombëtar dhe të bëjë rregullimet e domosdoshme.

Natyrisht, në marrëveshjen e Kigalit është parashikuar që këto amendime të hyjnë në fuqi në janar të 2019-s, njëkohësisht, ky është edhe një kusht, që duhet nënshkruar dhe ratifikuar nga një grup i caktuar vendesh.

Me amendimet e këtij protokollit Shqipëria nuk ka ndonjë problem apo detyrime që mund të lindin prej tij, përveçse të përforcojë dhe të zbatojë kërkesat për ndalimin, sepse Shqipëria nuk është vend prodhues. Kështu që nuk preket industria e prodhimit të këtyre kimikateve.

Ne jemi vetëm vend importues dhe si rezultat i nënshkrimit të këtij protokollit, kemi detyrimin të vendosim rregulla në doganë, për të lejuar vetëm listën e kimikateve që lejohen dhe për të ndaluar listën që është parashikuar në këtë protokoll. Kjo do të realizohet nëpërmjet nesh, si ministri që mbulojmë çështjen e mjedisit, dhe doganave.

Natyrisht, kjo do të ketë impakt në shkallë ndërkombëtare, në shkallë globale, më tepër për vendet që janë prodhuese dhe eksportuese të këtyre kimikateve.

Protokollin e Montrealit ka parashikuar edhe fonde të veçanta, përfituese e të cilave është edhe Shqipëria.

Ne prej disa vitesh kemi një program, i cili vazhdon, për rritjen e kapaciteteve kombëtare, për përmirësimin e legjislacionit kombëtar, për të asistuar të gjitha bizneset që e përdorin lëndën ozonholluese dhe për të monitoruar dhe raportuar në ministri dhe në protokoll për realizimin e këtyre objektivave.

Kështu që jemi të mendimit që ia vlen. Shqipëria është përfituese në zbatimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Kam një pyetje.

Sigurisht, nëse gjithçka shkon sipas ligjit, këtu duhet të futen vetëm substanca, të cilat nuk sjellin këto probleme.

A keni informacion nëse gjatë këtyre viteve, nga monitorimet që keni bërë ju, ka futje, tendenca kontrabandë të CFC-ve, për shembull, apo të produkteve të tjera, që janë të ndaluara me ligj, por që për shkak të kostos së ulët e të tjerë mund të behën pjesë e kontrabandës?

Pëllumb Abeshi – Deri tani, ministria nuk ka ndonjë informacion për futjen kontrabandë. Pjesa tjetër, kuotat e miratuara për vendin tonë, kontrollohen, monitorohen dhe

leja e importit të tyre jepet nga ministria. Kjo leje u kalon doganave dhe, dogana apo subjekti që do të importojë i kontrollon. Kështu që në aspektin procedural është i kontrolluar.

Ka pasur probleme në rastet kur janë importuar pajisje të përdorura, si frigoriferë të përdorur, të cilët kanë pasur probleme. Kemi bashkëpunuar me doganën për të gjetur... Këto pajisje të vjetra, natyrisht që kanë gaze ftohëse, që janë substanca të ndaluara... Në këto raste, ato nuk janë lejuar dhe janë kthyer mbrapsht.

Eduard Shalsi – Kishe gjë tjetër, Besnik?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka në Shqipëri aktualisht përdorim të këtyre lëndëve që do të ndalojmë?

Pëllumb Abeshi – Tani ne jemi vetëm importues, nuk kemi gjendje. Ato që janë lejuar të futen deri tani përfshihen te pjesët e lejuara të gazit. Tani e mbrapa të gjitha këto që ndalohen në listë, nuk do të lejohen. Kjo do të hyjë në fuqi në janar të 2019-s. Natyrisht, janari i 2019-s është relativ, sepse duhet ta ratifikojnë edhe 130 e ca shtete, nëse arrijnë ta ratifikojnë...

Eduard Shalsi – Sa nga të cilat e kanë ratifikuar deri tani?

Pëllumb Abeshi – Më duket se janë 98 shtete. Gjithë Bashkimin Europian e ka ratifikuar me një marrëveshje.

Eduard Shalsi – Për çfarë lloj substancash bëhet fjalë?

Është një listë këtu me hidroflorur dhe karbonet që janë...

Eduard Shalsi – Të gjitha janë lëndë importi?

Pëllumb Abeshi – Po, vetëm lëndë importi.

Besnik Baraj – Mbaj mend që ka qenë një projekt për zëvendësimin e gazave që kanë efekte serrë te frigoriferët.

A mendoni se është ezauruar, pra është bërë inventari i të gjithë frigoriferëve privatë dhe gazet e motorëve të tyre janë zëvendësuar me gaze që nuk kanë këtë efekt?

Pëllumb Abeshi – Ky projekt vazhdon akoma. Ka disa vite që asiston në ministri dhe faza e parë e projektit ka qenë inventarizimi, trajnimi i serviseve të frigoriferëve dhe një program që ofron ndryshimin e teknologjisë, të pajisjeve të mbushjes me gaz dhe të gazeve që u ... Në këtë aspekt, ka pasur një... Natyrisht, ndryshimi i shpeshtë i teknologjisë, jo vetëm i llojeve të gazeve, por edhe i teknologjisë që përdoret në pajisjet ftohëse, ka nevojë për trajnim dhe rritje kapacitetesh. Në këtë kuadër, protokolloi parashikon që vendin ynë është përfitues i fondeve që mund të asistojnë në këtë drejtim. Natyrisht, ne jemi të interesuar të aplikojnë dhe të na asistojnë për këtë qëllim, sesa thjesht për kontrollin doganor të sigurisë....

Besnik Baraj – Sigurisht, trajnimi është bërë i tillë, që, këto gaze grumbullohen dhe nuk emetohen në natyrë.

Çfarë destinacionesh kanë më pas?

Pëllumb Abeshi – Pastaj mënyra e asgjësimit...

Besnik Baraj – I djegin?

Pëllumb Abeshi – Asgjësohen me teknologji të miratuar, sepse edhe sot, pasi të dalë ky protokoll dhe ndalimi i këtyre në gjendje, që janë në përdorim nga pajisje ftohëse, mund të ketë gaze që janë të ndaluara dhe në momentin kur fillon ndryshimi i gazit, kompanitë detyrohen që këto gaze t'i asgjësojnë. I heqin nga pajisjet dhe i zëvendësojnë...

Besnik Baraj - I monitoron njeri? Sepse ato shpeshherë e kanë më kollaj të hapin rubinetin dhe të dalë në atmosferë dhe jo ta djegin sipas kriterëve.

Pëllumb Abeshi – Ne kemi vetëm projektin që asiston, ndërsa në aspektin e kontrollit është pak problem. Është e vështirë edhe për ne si ministri për ta realizuar. Ndoshta me Inspektoratin e Mjedisit mund të bëhet, por përsëri ai është proces i riparimit dhe i ndërrimit të gazeve, që duhet të jesh në moment aty...

Megjithatë, ne kemi futur si procedurë që ata duhet të mbajnë regjistër se ku i kanë çuar. Kanë hequr kaq gaz, se kanë pasur dhe është bërë inventari... Ti ke kaq litër gaz nga ky lloj gazi. Ku e ke çuar? Ata detyrohen të kenë kontrata me subjekte që janë të licencuara për adresimin e këtyre gazeve. Kjo është mënyra që ne mund t'i kontrollojmë.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Nëse nuk ka pyetje, sa të kthehet kolegu ynë, nuk e bëjmë dot votimin tani, domethënë ta dëgjojmë...

I përcjellim të ftuarit dhe ftojmë pjesën e dytë të të ftuarve.

Faleminderit!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.11.2018, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës, për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”. (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Dritan Bici dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Elvin Lako – Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Rudina Bollano - Drejtoreshë e Ekzaminimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Lindita Mëneri - Përgjegjëse e sektorit të markave, dizenjove dhe treguesve gjeografikë

Eduard Shalsi - Kalojmë te diskutimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës, për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”.

Të ftuar kemi zotin Laku, zonjën Bollano dhe zonjën Mëneri, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision!

Relatore kemi zonjën Piro.

Relatore, do të thuash diçka apo t’ua japim fjalën të ftuarve, që të na bëjnë një shpjegim dhe nëse kemi përgjigje...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Faleminderit!

Atëherë, zoti Lako, fjala është për ju.

Elvin Lako – I nderuar kryetar, marrëveshja e Lisbonës është e veçantë, në zbatim të nenit 19 të Konventës së Parisit “Për mbrojtjen e pronësisë industriale”.

Çdo vend anëtar i kësaj konvente mund të aderojë në marrëveshjen e Lisbonës dhe të bëhet pjesë e asamblesë së Unionit të Lisbonës, që ka autoritetin për të modifikuar rregulloret.

Kjo marrëveshje është nënshkruar në ’58-n, është rishikuar në Stokholm në ’67-n dhe amenduar në ’79-n.

Marrëveshja e Lisbonës parashikon mbrojtjen ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës në vendet anëtare të kësaj marrëveshjeje, përmes një regjistrimi të vetëm në zyrën ndërkombëtare të WIPO-s në Gjenevë.

Ajo u hartua në përgjigje të nevojës për një sistem ndërkombëtar, që do të lehtësonte mbrojtjen e një kategorie të veçantë, siç janë emërtimet e origjinës në vende të tjera, përveç vendit të origjinës, e ngjashme kjo me sistemin e Madritit për mbrojtjen ndërkombëtare të markave, ku Shqipëria ka hyrë që në vitin 2003, si dhe me sistemin e Hagës për mbrojtjen ndërkombëtare të dizenjove.

Në mënyrë që të mund të kualifikohen për regjistrim në zyrën ndërkombëtare të WIPO-s, një emërtim origjine duhet të ketë siguruar mbrojtje në vendin e origjinës.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është i vetmi institucion në Shqipëri, që regjistron objektet e pronësisë industriale, ndër to edhe treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Pak a shumë, marrëveshja e Lisbonës i parapriu edhe aktit të Gjenevës. Ky akt është miratuar tashmë nga Kuvendi i Shqipërisë. Akti i Gjenevës e ka përmirësuar marrëveshjen e Lisbonës. Përveç emërtimeve të origjinës, ky akt mbron edhe treguesit gjeografikë.

Cilat janë përmirësimet që ka bërë? Kundërshtuesi ose aplikanti mund të jetë edhe vetë personi që aplikon, jo nëpërmjet zyrës, siç e ka pasur marrëveshja e Lisbonës.

Arsyeja që ne aderojmë edhe te marrëveshja e Lisbonës, kur ne tashmë po aderojmë dhe jemi në proces tek akti i Gjenevës, ka të bëjë me faktin që akti i Gjenevës do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga vendet anëtare dhe do të hyjnë shtetet e tjera, pra do një farë kohe të hyjë, kurse marrëveshja e Lisbonës është në fuqi dhe janë 28 shtete anëtare, të cilat aderojnë. Kështu që bëhet automatikisht mbrojtja e treguesve gjeografikë në këto vende. Kjo është arsyeja pse akti i Gjenevës tashmë e ka përmirësuar marrëveshjen e Lisbonës, por kjo do kohën e saj për të hyrë në fuqi. Marrëveshja e Lisbonës ndërkohë është në fuqi dhe sigurohet mbrojtja ndërkombëtare e emërtimeve të origjinës që në momentin e aderimit të Republikës së Shqipërisë në këtë marrëveshje.

Eduard Shalsi – Ka ndonjë pyetje, kolegë? Nuk ka.

Presim pak Vullnetin, që u largua dhe do të kthehet përsëri.

Eglantina Gjermani – Faleminderit për prezantimin!

Ju keni shkruar këtu për produktet e certifikuara, se cilat janë disa... Këtu përfshihet mishi i kecit të Hasit, boronica e bjeshkëve kuksiane, e Tropojës e të tjera më radhë. Thoni se ka shumë produkte të kësaj natyre në Shqipëri dhe duhen identifikuar që të certifikohen.

Kanë kritere të caktuara?

I identifikoni ju apo duhet të vijnë te ju të identifikuara nga një institucion dhe më pas ju shikoni nëse plotësojnë ose jo kriteret?

Si është si procedurë?

Faleminderit!

Elvin Lako – Faleminderit!

Siç e kam shpjeguar, kemi dy grupe të mëdha, që janë emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë.

Shqipëria është një vend i pasur me këto. Këto ekzistojnë dhe nuk ka nevojë të... Si te pjesa e inovacionit të patentave, që duhet të kemi të bëjmë me një zhvillim teknologjik për të pasur pastaj dhe regjistrimin, që mbrohet nëpërmjet patentës. Këto janë aty. Thjesht regjistrimi i tyre behet jo nëpërmjet individit, sidomos tek treguesit gjeografikë, por nëpërmjet grupimit të atij grupi personash apo shoqatash, që, si të thuash, e mbarështojnë, e

prodhojnë apo e kanë këtë objekt. Këto thjesht duhen grupuar dhe aplikimi duhet të vijë si një aplikim i përbashkët, sepse prandaj ka të bëjë me vendin dhe nuk ka të bëjë me një person.

Edhe drejtorja, nëpërmjet promovimit, mund të ndikojë këtu, që personat që merren me prodhimin dhe nuk e kanë të regjistruar, t'i edukojë, në një farë mënyre, t'i mësojë se si bëhet mbrojtja e tyre kombëtare dhe më tej mbrojtja ndërkombëtare, nëpërmjet këtyre aderimeve që po kalojmë. Kjo është forma...

Ilir Beqaj – Boronica është e egër dhe ne vetëm e mbledhim, as e rrisim, as e mbarështojmë, as e krasisim... Vetëm e mbledhim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elvin Lako – Këtu dallojnë emërtimet nga treguesit. Kjo do të thotë se aty ku hyn procesi i njeriut, dallon treguesi me emërtimin. Kemi të bëjmë me emërtim origjine. Këtu ndryshojnë. Pra, kemi të bëjmë me produkte që, siç thoni ju, thjesht mblidhen dhe kanë të bëjnë me karakteristikën... Kjo do të regjistrohet si tipike. Kjo do të kalojë procesin e regjistrimit. Ky është një tregues gjeografik dhe ka lidhje me vendin, por thjesht duhen regjistruar. Për shembull, gështenja e Tropojës duke u regjistruar fiton mbrojtje kombëtare dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të mbrohet kur të tregtohet dhe të mos abuzohet nga dikush, i cili e shet në treg si gështenjë Tropoje, por, në fakt, nuk është e tillë. Domethënë, duhet t'i vendoset logoja, që në rastin konkret nuk është markë, por është tregues gjeografik.

Ilir Beqaj - Këtu ka diçka që lidhet me aspektin kur futet edhe kultivimi në këtë mes. Për shembull, molla e Dibrës vërtet rritet në Dibër, në një abitat klimatik të caktuar, por varietetet janë nga më të ndryshmet, dhe atje varet se çfarë zgjedhin që të kultivojnë. Si zgjidhet në këtë rast?

Elvin Lako – Bëhet aplikimi te ne, nga njerëzit që merren me këtë prodhim, dhe gjatë procesit të ekzaminimit i kërkohet një mendim i specializuar ministrisë përgjegjëse, që në rastin konkret është Ministria e Bujqësisë. Ministria jep mendimin nëse ky produkt i plotëson karakteristikat për t'u regjistruar me këtë emërtim. Nëse ministria e miraton, atëherë procesi i regjistrimit vazhdon më tej. Domethënë, këtu futen hallkat kompetente që merren me këtë punë, sepse ne si drejtori nuk e kemi ekspertizën për të identifikuar nëse ky produkt i plotëson këto karakteristika në rastin konkret apo jo.

Ilir Beqaj - Ne i përkasim një brezi dhe dimë t'i dallojmë mollët e Peshkopisë nga mollët e Korçës. Sot në fshatin Dvoran mbillen edhe kultivarë që i kërkon tregu për eksport, që ndoshta nuk janë mbjellë fare para 20 vjetësh. Praktikisht nëse ne jemi mësuar me mollën starkingë, por nëse kjo mollë do të kultivohet sot është pa leverdi edhe pse është mollë e Korçës.

Elvin Lako – Varieteti i farave është tjetër gjë. Domethënë, farat mbrohen diku tjetër dhe regjistrohen diku tjetër dhe varieteti i farave nuk ka të bëjë me treguesin gjeografik. Treguesi gjeografik ka të bëjë me një produkt, që është aty për shkak se duhet të jetë aty, sepse molla starkinge mund të mbillet në Dibër, por mund të mbillet edhe diku tjetër.

Ilir Beqaj – Në Dibër mund të mbillen mollë me 10 varietete të ndryshme. Të 10-ta këto varietete do të quhen mollë Dibre?

Elvin Lako - Jo, do të quhen vetëm ato që kanë lidhje me vendin.

Ilir Beqaj – Kam përshtypjen se këtu ka një lloj inflacionimi, sepse nuk mund të ketë 10 mollë Dibre me ngjyra të ndryshme dhe me shije të ndryshme.

Elvin Lako – Farat janë tjetër gjë, kurse ne po flasim nëse kjo mollë mbillet aty ka këtë atribut dhe nëse mbillet diku tjetër, nuk e ka këtë karakteristikë. Pra, po flasim për vendin, kurse farat janë tjetër gjë.

Ilir Beqaj – Çfarë avantazhi ka vendi në qoftë se ne i vendosim në këtë rast një emërtim “mollë Dibre”, sepse ato janë 15 mollë të ndryshme?

Elvin Lako – Do të jetë ai produkt që do të mbrohet.

Ilir Beqaj – Aq më tepër që nuk bëhet fjalë për varietet autoktone, të cilat me të vërtetë mund të kishin kuptim...

Elvin Lako – Për autoktone bëhet fjalë...

Ilir Beqaj – Nuk ka më autoktone, sepse autoktonet janë specie në zhdukje.

Elvin Lako - Po këto autoktonet do të mbrohen. Ne kemi, për shembull, ujin “Glina”, mjaltin e të tjerë.

Ilir Beqaj – Mjalti është ndryshe, sepse lidhet me një kullotë specifike.

Elvin Lako – Kështu lidhen edhe këto me zonat, sepse të gjitha këto kanë një zonë specifike.

Ilir Beqaj – Ka rreth 15 vjet që nuk mbillet asnjë dru frutor në Shqipëri që nuk shkon në eksport.

Elvin Lako - Nuk po flasim këtu për varietetet e farave, por po flasim për produktet që kanë lidhje me vendin. Pra, ai produkt në një vend tjerë nuk bëhet. Për shembull, kemi dhinë e Hasit, e cila ka karakteristikat e zonës dhe është e certifikuar.

Ilir Beqaj – Nuk mund të quhet dhi e zonës, sepse ajo vetëm në atë zonë rritet.

Eduard Shalsi – A ka ndonjë gjë tjetër ka kolegët?

Zoti Ervin, a ka ndonjë zhvillim të ri nga sektori? Ju lutem, na bëni një përshkrim të shkurtër se çfarë ka ndodhur?

Elvin Lako - Në këtë vit ka vazhduar rritja e aplikimeve të markave, domethënë është kaluar rreth 20% më shumë se vjet, sidomos i markave që janë me aplikant shqiptarë që këtu kemi dashur që produktet vendase të ecin më tej dhe të mbrohen nëpërmjet mbrojtjes së logove të markave të tyre. Reforma është në proces dhe ligji i ri ka filluar efektet. Shumica e akteve nënligjore janë miratuar dhe pritet që të miratohen edhe 3 apo 4 akte të tjera, të cilat do të plotësojnë të gjithë kuadrin ligjor.

Gjithashtu, është rritur në numër edhe struktura e drejtorisë, që do t'u përgjigjet nevojave të shumta që ka, sepse është shtuar puna. Patjetër, duke u rritur aplikimet, janë shtuar edhe procedurat dhe të gjitha i kemi sipas direktivave të fundit. Mënyra e ekzaminimit nuk është thjesht formale, siç ka qenë në të kaluarën, por sot bëhet për të gjitha shkaqet, sidomos për pjesën e markave industriale.

Eduard Shalsi – Këto 20 marka...

Ervin Lako – Jo, janë 20% më shumë.

Eduard Shalsi – Ku konsistojnë më shumë? Çfarë karakteristikash apo çfarë lloj marke ka një produkt interesant?

Ervin Lako – Janë të të gjitha fushave, sepse markat ndahen me klasa, por në dy klasat më të mëdha janë markat, të cilat ne jemi përpjekur t'i shtojmë dhe jo thjesht te produktet, por edhe te shërbimet. Pra, ka filluar që të shtohet edhe numri i markave të shërbimit. Ky ishte efekti strategjisë...

Eduard Shalsi - Për shembull?

Ervin Lako – Për shembull, një shërbim që mund të ofrojë një bankë e caktuar, e cila mund të thotë hajdeni te ne se ka këtë dhe ajo logo mbrohet. Pra, jo thjesht një produkt i caktuar ka logon e saj, por kjo ndodh edhe te shërbimet.

Kjo ndodh për arsye se në Shqipëri ka më shumë shërbime se produkte dhe këtë ne e kemi nxitur nëpërmjet promovimit, duke shkuar te çdo biznes dhe duke i sqaruar për të mirat dhe benefitet që ka nga regjistrimi, se si mbrohet më mirë produkti i tij, si identifikohet në treg dhe po përpiqemi që markat të marrin një vlerë. Po ashtu këtë gjë e kemi bërë edhe për patentat, por kjo është më e vështirë, sepse ka të bëjë me shumë institucione, me inovacionin, si dhe me zhvillimin teknologjik të vendit. Por, patjetër, edhe aty që ka progres, sidomos patentat e huaja, që mbrohen në Shqipëri janë rritur dy –tre herë në krahasim me shifrat që kanë qenë në të kaluarën.

Eduard Shalsi – A janë ulur konfliktet e piraterisë?

Ervin Lako – Duke u shtuar regjistrimi, patjetër që do të rriten. Në të gjitha vendet e zhvilluara 1 në 5 marka kundërshtohet, por ne kemi shkurtuar procedurat për shkak se ka

filluar funksionimi i dhomave pranë drejtorive të shqyrtimit të kundërshtimeve, në mënyrë që të mos ketë afate të tejzgjatura në gjykatë, por ato zgjidhen menjëherë në drejtori dhe i kalon të gjitha hallkat. Kështu, në këtë mënyrë pronari fiton një të drejtë më të shpejtë se të shkojë në gjykatë me vite.

Eduard Shalsi – Cilat marka ia vlejnë te produktet shqiptare?

Ervin Lako – Të gjitha ia vlejnë.

Eduard Shalsi – A ka ndonjë markë interesante që të tërheqë vëmendjen?

Ervin Lako – Ka me dhjetëra marka dhe fakti që ka edhe konflikte tregon se markën e përdorin edhe individët, edhe bizneset.

Eduard Shalsi – Për shembull, bashkë me zotin Baraj, bëme një vizitë në një fabrikë shqiptare, e cila importonte 80 tonë mollë nga Polonia...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Detyra jonë është që ta incentivojmë dhe ta orientojmë ekonominë e tregut.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo fabrikë e merrte mollën të përpunuar, të presuar, të tharë, jo thjesht si koncentrat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Ervin, ju falënderoj dhe ju uroj punë të mbarë!

Ervin Lako – Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Beqaj, a keni pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të nderuar kolegë deputetë, për të përmbyllur atë që nisëm pak më parë, kalojmë në miratimin e dy marrëveshjeve që diskutuam.

Marrëveshja “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës, për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës së regjistrimit të tyre ndërkombëtar”.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë në tërësi projektligjin. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te marrëveshja e dytë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentet e Kigalit, të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

Hedhim në votim projektligjin në parim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë në tërësi projektligjin.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.11.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe votimi nen për nen i paketës fiskale (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Dritan Bici dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë

Aurora Alimadhi - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë

Irfan Tarelli - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Enea Hoti - Drejtor i Përgjithshëm i Rregullatores dhe Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural.

Agron Vata - Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Niko Lera – Përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuçi – Përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Jonida Kaza – Përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Doriana Toro – Përfaqësuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Arben Krasniqi – Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Benet Fociro – Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eduard Shalsi - Kalojmë në diskutimin për paketën fiskale.

Të ftuar nga Ministria e Bujqësisë kemi zotin Halilaj, zonjën Alimadhi, zotin Tareli dhe zotin Vata, nga Ministria e Financave kemi zotin Lera dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kemi zonjën Enkeleda Kuçi, zonjën Jonida Kaza, zonjën Dorianë Toro, zotin Arben Krasniqi dhe zotin Benet Fociro.

Çështja e fundit që ka ardhur është kërkesa e një grupi biznesmenësh në lidhje me nenin 94/1 “Për shkeljet në qarkullimin e pullave fiskale” për të cilin kemi vijuar një diskutim me ministrinë dhe të shohim nëse është rënë dakord për riformulimin e nenit. Nga biznesmenët ka një shqetësim në lidhje me formulimin siç është dhe ashtu siç duhet bërë. Shpresoj që të kemi një përgjigje sot.

Në lidhje me çështjen e buxhetit për Ministrinë e Bujqësisë, kemi rakorduar për dy programet, “Për zhvillimin rural” dhe “Për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen së konsumatorit”, për të cilat në pamundësi për të shtuar buxhetin e ministrisë duhet të bëjmë një rialokim të brendshëm, duke transferuar 100 milionë lekë tek Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe 100 milionë lekë për programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja konsumatorit”, respektivisht për Institutin. Këto janë dy çështjet për të cilat kemi rënë dakord në pamundësi për të shtuar buxhetin.

Meqenëse jemi te buxheti, a ka ndonjë gjë për Ministrinë e Bujqësisë.

Fjalën e ka zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Gjatë diskutimit në parim, mes të tjerash diskutuam edhe për vlerësim të gjërave që kanë ndodhur, mbi të cilat duhet të ndërtojmë se çfarë duhet të bëjmë. Unë falënderoj ministrinë dhe sekretaren e përgjithshme që na është përgjigjur për ujitjen, por ndoshta duhet të kërkoj ndjesë, meqenëse e kam iniciuar këtë kërkesë, se nuk kam qenë i qartë kur kam bërë kërkesën, sepse në vlerësimin tim përgjigjja nuk ka informacion.

Ju thoni që rezultatet pozitive janë: “Rritja e moderuar, por e qëndrueshme e prodhimit bujqësor në 3-4 vjetët e fundit dhe shtimi i sipërfaqeve të mbjella kryesisht në zona të ujtitshme”, por nuk jepen shifra. Këtë fjali ne e dimë që para një muaji dhe ne ju kërkuam informacion, ndërsa kjo që thoni ju është opinion. Ju me siguri keni informacione, por këtu nuk keni sjellë gjë.

Ju thoni: “Struktura e kulturave bujqësore po ndryshon në favor të atyre me vlerë të lartë tregu, të cilat e kanë ujitjen e domosdoshme (perime, ullishte, pemë frutore, agrume e të tjerë) sipërfaqja e mbjellë me këto kultura është rritur çdo vit me nga një hektar”. Po sa ka qenë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është rritur, po sa ka qenë? Ka qenë 100 dhe është bërë 101, 102 dhe 103, apo ka qenë 1 dhe është bërë 2, 3, dhe 4? Kjo është shumë e ndryshme.

Ju thoni: “Rritja e ndjeshme e rendimenteve të prodhimit të disa kulturave si pemë frutore, ullishte e të tjerë.” Por nuk i ilustroni se sa ishte për rrënjë në një vit dhe sa u bë, sigurisht duke na shpjeguar edhe sezonalitetin, sepse dihet që ulliri nuk është çdo vit njëlloj, siç e shpjegoni që ka shumë faktorë të ndryshëm.

Pastaj thoni: “Në skemat ujitëse të rehabilituara është rritur numri i fermerëve... e të tjera, që aplikojnë me grante të mëdha”. Po sa është rritur? Sa nga grantet që ishin në dispozicion në vitet 2015, 2016 dhe 2017 shkuan për këto gjëra? Nëse nuk i mbajtet shënim, ne ua nisim përsëri me shkrim kërkesat dhe na sillni përgjigjet. Këto përgjigje që na sollët nuk kanë informacion, kanë opinione dhe pozicione.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Meqenëse mund të na ndihmojë edhe për një diskutim në një moment tjetër, rritja e tatimit të taksës për granulat që do të prodhojnë tuba plastikë për ujitje, a mendoni që afekton sektorin tuaj? Çfarë pasojash ka? Cili është reagimi juaj?

Ilir Halilaj—Në lidhje me rritjen e taksës për granulat e prodhimit ne vëmë re që shumica e materialeve që përdoren në bujqësi për ujitjen janë të importuara të gatshme nga jashtë, por çdo rritje takse në lëndën e parë të prodhimit të këtyre materialeve do të prekte dhe kostot e fermerit në implementim.

Po flasim për rritjen e granulave që është lënda e parë.

Eduard Shalsi- Ju lutem, përgjigjuni vetëm nëse keni përgjigje.

Ilir Halilaj - Nuk mund ta kuantifikojmë përgjigjen.

Eduard Shalsi- Mos tentoni t’i përgjigjeni një gjëje për të cilën nuk keni përgjigje. Pra, ka qenë 100 lekë për ambalazhet, tani vendoset për lëndën e parë 25 lekë, ndërsa 100 lekëshi u bë 35 lekë. Kjo është për të gjithë plastikat.

Jemi në një dilemë të madhe sot ndoshta do ta konsolidojmë, por pyetja që bëri Besniku është një pyetje që ia kemi bërë vetes për një muaj rresht, që do të thotë, nëse i keni studiuar jepini një përgjigje, nëse jo është më mirë të thoni se nuk i dini pasojat.

Ilir Halilaj – Sa u përket pyetjeve të zotit Beqaj ne dërguam një material përmbledhës që cilëson investimet në ujitje. Në funksion të prodhimit do ta detajojmë në shifra rritjen e sipërfaqeve dhe prodhimit, por duhet thënë se janë disa faktorë që ndikojnë. Ujitja është një prej këtyre faktorëve. Ujitja ndikon në rritjen e prodhimit, ndikon edhe në lehtësimin e kostove të fermerit për ujitje. Pra, afërsia që ka fermeri me ujin ul koston.

Eduard Shalsi- Gjej rastin ta ngre prapë shqetësimin tim. Irfani do ta ketë dëgjuar me dhjetëra herë besoj Agronin, por për Ilirin dhe Aurorën them se ka 3-4 vjet që duke ditur problematikën e madhe të të dhënave dhe statistikave dramatike që kemi trashëguar në lidhje me bujqësinë, e kam konsideruar shumë të rëndësishëm fillimin e investimit në bazën e të dhënave në bujqësi. Në momentin që nuk jemi në gjendje t'u përgjigjemi pyetjeve bazike me saktësi ju siguroj që vendimmarrjen do ta kemi të gabuar.

Beqaj, ka një muaj që ka bërë disa pyetje, një muaj po e themi për modesti, por, në fakt, ka më shumë se një muaj dhe mosdhënia e informacionit nuk ka të bëjë me mungesën e dëshirës, ne e kuptojmë këtë, por ka të bëjë me të dhënat e pasakta që ekzistojnë në ministri. Ashtu ka qenë madje Ministria e Bujqësisë, e cila vite më parë jepte shifra për të mbushur sukseset. Tani nuk kemi nevojë ta bëjmë këtë gjë, e kam diskutuar edhe me ministrin, edhe me përfaqësues të ministrisë, por nuk mund të ecim më me këtë bazë të dhënash në bujqësi. Më kujtohet herën e fundit diskutimi për bletët, kur donim të financonim sektorin e bletarisë dhe pyetja e parë natyrisht ishte: sa koshere kemi në Shqipëri? Nuk e dinim. Po kur pyetëm si do të zgjidhet, a e mbani mend çfarë përgjigjeje morëm? Do mbështesim skemat me ato bletërritës që kanë më shumë se 100 koshere, por nuk dihej sa ishin dhe ku ishin. Ndaj ka ardhur momenti që të investohet fuqishëm në bazën e të dhënave dhe unë do t'ju mbështes dhe jeni në çdo moment të mirëpritur, sepse nuk ka të dhëna të sakta për fermerët që kemi ndihmuar për të parë çfarë efektesh ka prodhuar mbështetja për fermerët.

Rakip Suli - A e keni mbaruar reformën me drejtoritë e bujqësisë në rrethe, a ka filluar puna?

Ilir Halilaj- Po ka filluar puna.

Eduard Shalsi- Do të duhet të mbani shënim këtë gjë, sepse unë them vazhdojmë ta kemi shqetësim madhor. Nuk e di cili është mendimi i Ministrisë së Financave, por sipas mendimit tim sa më e saktë të jetë baza e të dhënave, aq më e saktë është vendimmarrja. Nuk është faji juaj, por duhet të vijë një kohë që baza e të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë të saktësohet dhe modernizohet.

Tani kalojmë te çështja e imputeve bujqësore. Kemi rënë dakord ta bëjmë zero TVSH – në e imputeve bujqësore. Këtë e ka kërkuar Ministria e Bujqësisë, ne si komision e kemi mbështetur, do t'ia dërgojmë komisionit përgjegjës.

A ka ndonjë gjë për të saktësuar në këtë pikë?

Ilir Beqaj – Çfarë mekanizmash disponojmë ne për të reaguar nëse në janar dhe shkurt nuk ndodh asgjë te çmimi me pakicë i imputeve?

Ilir Halilaj – Ne nuk kemi asnjë mekanizëm që të imponojë që reduktimi i një niveli tarifor ose heqja e detyrimit doganor për një produkt të caktuar automatikisht të çojë në uljen e çmimit. Ne kemi bërë llogaritjet dhe, nëse furnizimi me fara, fidanë, insekticide e të tjera, pra imputeve bujqësore do të përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar, shteti nuk do të arkëtojë 1,3-1,4 miliardë lekë në vit. Pra, duhet ta marrim parasysh këtë që edhe në buxhetin e vitit 2019 të ulim të ardhurat për 1,4 miliardë lekë.

Ilir Beqaj – Zëvendësministër, unë do të doja ndihmën tuaj që të na sillni sa më parë të jetë e mundur një informacion se çfarë do të ndodhë konkretisht në janar me nitratin, fosfatin, e të tjera me radhë ose më saktë se çfarë pritet të ndodhë, se atë çfarë do të ndodhë e vendos tregu, siç e tha edhe Niko.

Nga një ngarkesë 20% në një ngarkesë 0%, çfarë do të duhet të ndodhë me secilin nga këto inpute, sepse lista mund të jetë me 1 mijë, por 5, 10 apo 15 që ju i dini, që janë më të ndjeshmet, më të përhapurat, më të përdorshmet e të tjera.

Unë mendoj se do të na duhet të fillojmë një komunikim sa më aktiv dhe më intensiv në gjithë territorin e Shqipërisë për të rritur, në kuptimin jo të keq të fjalës, presionin pozitiv ndaj tregtarëve që mund të mendojnë të bëjnë kartela, *trepole*, *quattropole* e të tjera. Pra, fermeri duhet të jetë i përgatitur që në mes të muajit janar e prapa, kur të shkojë atje, të mos presë atë që ka sot, por atë që do të duhet të ketë. Mundësisht, që ne të mos bëjmë improvizime, pasi ju merreni me këtë punë, keni bërë një analizë, sot janë në treg 1, 2, 3 apo 4, sa do të duhet të jenë në qoftë se ai do ta shesë me zero.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Nga doganat kemi disa përfaqësues. Kush nga ju do të flasë? Më parë, a mund të komunikoni pak me Manjolën në lidhje me shkeljen në qarkullimin e pullave fiskale?

(Diskutime pa mikrofon)

Jemi te inputet bujqësore. A mbaruat? Jo.

Ilir Ndraxhi – Sa u takon inputeve bujqësore ne e dimë përmendësh se çfarë duan fermerët. Fermerët duan plehrat kimikë, pesticidet dhe lëndën e parë, por jo vetëm kaq, por duhet të kemi kujdes edhe mbi origjinën nga vijnë këto produkte, pra origjina e ardhjes. Ju duhet të vendosni si Ministri e Bujqësisë kritere, pra duhet ta diktoni që produkti duhet të vijë nga këto firma që kanë këtë prodhim...

Ju, si Ministri e Financave, duhet të keni parasysh tatimet për të gjitha pikat që bëjnë importin dhe shpërndarjen e tyre, kontrollin, nëse zbatohen rregullat, a i paguajnë të gjitha

taksat e të tjera. Në qoftë se u bëjmë nder fermerëve, që ata të paguajnë 20% më pak, të mos lëmë që të bëhen abuzime me importuesit dhe treguesit e këtyre mallrave.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Unë kam diçka tjetër sa u takon inputeve bujqësore. E kam miratuar nismën, duke besuar fort edhe në implementimin e një sistemi që quhet *tracke and trace*, të gjurmueshmërisë, i cili do t'i japë përgjigje dhe do të lehtësojë edhe procesin e menaxhimit. Vërtet mund të mos ketë menaxhim, por të paktën gjurmueshmërinë dhe ecurinë e çmimit do ta kemi më shumë të qartësuar. Unë për vete do të vazhdoj ta kërkoj këtë gjë, madje vitin tjetër do ta kërkoj edhe më fort se pse nuk është implementuar, pra sistemin e gjurmueshmërisë të inputeve bujqësore. Nuk është thjesht vetëm për çmimin, nuk është thjesht vetëm për evazionin, por ka të bëjë me monitorimin dhe sigurinë e produkteve, pra nga vijnë, cilët janë importuesit kryesorë dhe në çfarë hapash do të kalojmë?

Për inputet bujqësore, e ka kërkuar fjalën zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Kisha një pyetje për Ministrinë e Bujqësisë. A kemi ne standard të miratuar për plasmasin e serrës?

Ilir Halilaj – Në lidhje me këtë do t'ju kthej një përgjigje, por standardi që mbështesim me skemat e AZHBR-së për investimet në serra është standardi i plasmasit termik me garanci 3 deri në 5-vjeçare. Ky është standardi që ne mbështesim, por ndërkohë sa u takon elementeve përbërës që duhet të ketë ky...

Ilir Beqaj - Shqetësimi im është ky, në qoftë se kemi këtë standard që e mbështesim, sepse ju besoni se ky i vlen fermerit. Pra, në qoftë se është në këtë mënyrë ne nuk duhet ta lejojmë, sepse ai fshatari atje, fermeri, sheh një tabelë në një dyqan normal që shet plastmas për serrë dhe shkon e blen. Në pamje të parë mund ta blejë pak më lirë, se gënjehet, por ky plastmas mund ta marrë në qafë me gjithë prodhimin. Po të jetë kështu, nuk është puna vetëm aty ku ju keni zgjedhur me të vërtetë për t'i mbështetur, por për gjithë bujqësinë, të paktën ju sugjeroj, duhet një standard që më pas dogana ose prodhimi vendas ta ketë për detyrë ta kontrollojë standardin. Pra, në qoftë se është më e lehtë në doganë, cili është institucioni që kontrollon standardin e prodhimit vendas, sepse në doganë kemi kontroll, por prodhimi vendas mund të jetë në një fabrikë, si dhe shkalla e respektimit të standardit.

Eduard Shalsi – Zoti Ndraxhi, e konsiderojmë të ezauruar çështjen e inputeve. A keni ndonjë gjë tjetër për inputet bujqësore?

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Ndraxhi – Duhet të saktësojmë edhe formulimin.

Eduard Shalsi - Formulimi është shumë më i gjerë se sa këto të tria që u përmendën. Formulimi te inputet bujqësore është një nocion që përfshin shumë elemente brenda...

(Diskutime pa mikrofon)

Nikolin Lera – Edhe nëse inputetet bujqësore do të jenë të përjashtuara apo me tarifë zero nga 20% që janë...

Eduard Shalsi – Jo të përjashtuara, por me TVSH zero.

Nikolin Lera – Kjo është vendimarrja juaj, por ne përsëri duhet të përcaktojmë me vendim të Këshillit të Ministrave listën analitike, sepse duhen kode tetëshifrore. Nëse e lëmë të gjithën kështu, atëherë do të ketë probleme të jashtëzakonshme. Pra, në ligj duhet do të jepet parimi që inputet bujqësore përfshirë: fara, fidanë, plehërues, insekticide janë me tarifë zero dhe Këshilli i Ministrave përcakton... Ndryshe...

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ato kodet që vihen në ligj, ashtu siç tha edhe kodin e 39-ës për plastikën, na i jep këtu.

Nikolin Lera – Po mund të jenë 200 kode...

Ilir Beqaj – Fletorja Zyrtare do t'i përmbajë të gjitha këto, sepse në qeveri e di unë se çfarë mund të dërgoni ju, le të zihemi ne pastaj...

Nikolin lera – Në qeveri do ta dërgojë Ministria e Bujqësisë së bashku me ne jo vetëm ne...

Ilir Beqaj – Parlamenti. Ne mund të vëmë listën në aneks, le të jetë me 2 mijë faqe...

Aurora Alimadhi – Më falni për shqetësimin, por Ministria e Financave e ka përcjellë edhe më parë te ne, por ne vlerësojmë se është praktikisht e pamundur që të bësh një listë shteruese të këtyre materialeve, për shkak se procesi i regjistrimit është shumë dinamik. Çfarë nënkupton kjo? Mundet që në situatën aktuale të jetë një lloj inputi, një pesticid, që nuk ekziston në tregun shqiptar dhe në një të ardhme të afërt një subjekt i interesuar mjafton që e ka të regjistruar në BE, vjen dhe kërkon regjistrimin në Shqipëri. Në këtë kuptim i bie që lista nuk është shteruese, por është dinamike, e ndryshueshme. Nuk e di se si mund të gjejmë një lloj zgjidhjeje në raport me përcaktimet e kodeve doganore, por edhe ta evidentosh dhe ta konsiderosh një listë një herë e përgjithmonë, nuk e gjykoj të bazuar.

Nikolin Lera – Nuk e kam fjalën për listë superanalitike produktesh, por të paktën në nivel katërshifror. Pra, janë teknikalitete që dogana duhet t'i zbatojë, sepse përndryshe hapet rruga për evazion. Nëse ne lëmë vetëm një parim dhe nuk përcaktojmë se cilat janë kode të nivelit katërshifror, për të mos kaluar në nivelin tetëshifror në detaje, atëherë do të

ketë një problematikë të madhe me evazionin. Ne nuk duhet të miratojmë ligje, të cilat lejojnë shteg për abuzim.

Eduard Shalsi – E ka kërkuar, zoti Beqaj, fjalën.

Ilir Beqaj – Aurora, nuk jam dakord me ju. Unë kërkoja listë të miratuar, por lista nuk është me artikuj...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk është ashtu. Ministria përkatëse mund të thotë: katërshifrori nuk ka artikuj, as tetëshifrori. Ne kemi një nomenklaturë mallrash që e miratojmë zakonisht çdo 30-vjetor, që është një libër i trashë, dhe produkti europian, që ju me të drejtë thoni, patjetër, që kur niset, brenda DG21-it i përket një kodi tetëshifror. Ne atë marrim si bazë, nuk e shpikim ne atë kod. Po flasim për kodet dhe kodet nuk janë listë artikujsh. Ajo mund të shkojë me 7-8 shifra pastaj.

Për mua nuk dua t'ia lërë Ministrisë së Financave, që gjithmonë do të anojë nga lista e sa më e reduktuar, s'mund ta lëmë të hapur. Dikush mund të ketë hallin e evazionit, ndërsa unë kam hallin e korrupsionit që mund të vijë ndjeshëm, se pastaj do të varesh nga ai që të interpreton mallin, nëse do doganieri, ta kalon, nëse s'do nuk ta kalon. As këtë hapësirë nuk duhet ta lejojmë. Në qoftë se kemi vështirësi, le të presim 1 janarin e vitit që vjen për një imput që nuk na ka ardhur kurrë në Shqipëri, por të lehtësojmë gjithë pjesën tjetër pa krijuar hapësira ku mund të hyjmë në situata evazive dhe korruptive, sepse unë kam shumë merak, pasi të dyja, veç të tjerash, krijojnë mjedis për konkurrencë të pandershme.

Nikolin Lera - Parimi i ligjit të tatimit mbi vlerën e shtuar jep preambulën kryesore, tarifën, përjashtimin ose jo e përjashtuar. Për çdo nen tjetër të ligjit, ne ia kemi alokuar vendimit nr. 943 të Këshillit të Ministrave, pra kur themi: “-Janë të përjashtuara materialet, pajisjet, makineritë për investime mbi 50 milionë lekë”, themi se: “-Sipas listës së miratuar me VKM janë të përjashtuara filan lloj furnizimesh”. Nuk është e mundur që për një lloj malli të themi se listën do ta vendosim në ligjin e TVSH-së, nuk bën sens në kuptimin se si është dizenuar ligji dhe aktet nënligjore.

Ilir Beqaj - Kam një pyetje për ministrin e Bujqësisë: a kemi perkufizim ligjor të imputit bujqësor?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Irfan Tarelli – Termi “imput bujqësor” është kategori teknike dhe nuk është e përkthyer në një normë ligjore, ndërsa kur flitet për material mbjellës si: farat, fidanët, pesticidet, plehrat kimike ka definicion të qartë në ligjet përkatëse.

Së dyti, kemi konceptin e regjistrimit. Pra, në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk mund të hyjë asnjë nga këto impute jashtë konceptit të regjistrimit dhe ka procedurë të përcaktuar ligjore.

Së treti, lista është dinamike. Mund të ndodhë që e njëjta lëndë aktive të vjen me emërtim tjetër në formulimin tregtar.

Këto janë tri aspektet që duhet të konsiderojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka vështirësi në evidentimin në sistemin e doganave, sepse vjen me emrin tregtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që e ka! Por gjithsesi, koncepti i regjistrimit ka të dy elementet brenda kur flasim për produkte kimikë, ka emrin tregtar ka edhe lëndën aktive. Të dyja paralelisht.

Eduard Shalsi – Për zhavorret bituminoze, propozimi ishte 2, qeveria e solli me 1. Jemi te 0,3%? Ky është propozimi që duam të mbështesim ne.

Nikolin Lera – Ne propozuam 2 dhe ishte tarifa e unifikuar dhe produktet paralele, madje i favorizuar, sepse nuk parashikon taksën e karbonit. Pra, 2 është akciza, plus 3 taksa paralele për produktet e karbonit, shkon te 2 me 5. Tani të shkosh nga 2 me 5, në 5 me 0,3, nuk e kuptoj çfarë logjike mund të ketë një akcizë në nivele të tilla shumë të ulëta! Mendoj që ose të ngelet 1, ose minimumi të reduktohet të paktën në gjysmën e saj.

Eduard Shalsi – 2 specifika na lejuan të zbrisnim në këto nivele:

1- fuqia kalorifike, si lëndë zëvendësuese e koksit, diferenca me të cilin ishte 90% koksi, 20% kjo;

2- konteksti, kishim minierat e Selenicës, për ato bëhej fjalë, të cilat kishin mirëmbajtjen e kraterit, elemente të tjera, të cilat do të duhet t'i merrnim në konsideratë;

3- masa që zinte akciza te kostoja e produktit, e cila ishte shumë e lartë, për hir të së vërtetës.

Për të gjitha këto arsye, llogaritëm që është e përballueshme për biznesin 0,3.

Këto ishin 3 elementet që na bënë të...

Nikolin Lera - Jeni shumë i saktë!

Po ju jap një shembull lidhur me fuqinë kalorifike: ne taksojmë edhe solarin, edhe benzinën me 37 lekë. Dihet fuqia e të dyjave, pra, fuqinë energjetike nuk e përdorim si kriter matës për të përcaktuar nivelin e akcizës. Ka shumë kritere të tjera që hyjnë në llogaritje.

Eduard Shalsi – Ndaj nuk e përmenda si të vetmin, por thashë bashkëshoqëruar me peshën specifike që zë taksa e akcizës në koston e produktit.

Nikolin Lera –Ndërkohë, për elementin e tretë që përmendët, në llogaritjet 1 lekë për zhavorrin bituminoz, shkuam te niveli i ngarkesës fiskale te 40 %.

Eduard Shalsi – Jo, me 1 lek shkonte shumë më tepër.

Nikolin Lera –Ata e shesin me 2200 lekë tonin. 2200 lekë me 1000 aty shkon, te 40%, ndërkohë që edhe produktet e tjera konkurente me 5 lekëshin, shkojnë te 40%.

Eduard Shalsi – Na doli 60% tani!

Nikolin Lera – Gjithsesi, unë mendoj se reduktimi deri në 0,3 lek është drastik!

Robert Bitri – Niko, aty u tha shumë qartë se për një rritje të tillë, prodhimi është ndërprerë 1 vit. Nuk mendon se kjo mund të rriskojë prapë që ata të ndalojnë prodhimin dhe pasojat janë ato që janë?

Nikolin Lera – Nuk u ndërpre prodhimi për zhavorrin bituminoz, sepse nuk është vendosur ndonjëherë akcizë për zhavorrin bituminoz. U ndërpre prodhimi për bitumin. Çfarë bëri Ministria e Financave në vitin 2015, në mos gaboj? U pa që përcaktimi i nivelit të rentës dhe akcizës, në disa raste me përqindje krijonte evazion të madh, sepse subjektet mashtronin me çmimin e shitjes, sepse akciza apo renta me përqindje llogaritej mbi çmimin e shitjes dhe u pa e arsyeshme që të vendosej me kuota fikse për njësi. Duke u vendosur me kuota fikse, u bë një gabim teknik për bitumin, i cili u rregullua në vitin pasardhës, u bë 2300 e diçka. Pra, jo zhavorri bituminoz.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund t’jua them tani, sepse duhet të shoh shifrat! U rrit në një mënyrë të paarsyeshme, të themi, dhe u korrigjua direkt, por nuk kishte lidhje me zhavorrin bituminoz.

Eduard Shalsi – Nuk kishte lidhje, por ama, ishte një indikator që tregonte se çfarë impakti kishte për biznesin një rritje e tillë, që u pranua se ishte lapsus.

Nikolin Lera –Ne tani po bëjmë llogaritje teknike.

Eduard Shalsi – E qartë, por në finale, afekton koston. Ajo që ne kalkulojmë tani është:

nëse rritet, ç’ndodh me prodhimin? Në rast se na duhet të hamendësojmë se me kolon që hëngri, prodhimi do të bllokohet, do të frenohet, atëherë pasojat janë ato që kemi diskutuar. Gjithsesi, t’ia bëjmë propozimin me 0, 5.

Besnik Baraj – Unë jam për 0, 4.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam për diçka të ndërmjetme, mes 0, 5 dhe 0, 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më dëgjo pak. E para, ne nuk dimë çfarë rezervash ka prej atyre qymyreve, çfarë ndikimi kanë në ambient. Edhe unë bashkohem me Besnikun: 0,4. Me 0, 4 jemi në rregull.

Eduard Shalsi – Atëherë po i propozojmë 0, 4.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord për 0, 5? Vetëm Beqaj.

Kush është për 0, 4? Dakord!

Mirë, do t'ia propozojmë me 0, 4 atëherë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me zhavorrin bituminoz? Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zhavorrin. Jemi te zhavorri bituminoz.

Nikolin Lera – Rëra bituminoze, e cila gabimisht ishte karakterizuar si e akcizueshme, u hoq fare. Rëra bituminoze është e përbërë nga ato mbeturinat, të cilat nuk përdoren fare si lëndë djegëse, po vetëm si shtresa asfaltimi nëpër rrugë rurale. Pra, me këtë ndryshim kodi që po bëjmë rregullojmë dy gjëra njëkohësisht: vendosim akcizë për këtë produkt apo për zhavorrin bituminoz me 0, 4, siç e propozuat ju, dhe ua mbyllim gojën produkteve konkurrenente, por nga ana tjetër heqim edhe akcizën që ishte vendosur gabimisht për rërën bituminoze.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Logjika është që akciza vendoset për produkte energjetike. Rëra bituminoze nuk është produkt energjetik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, për shtresa. Por nuk është produkt energjetik, për djegie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, gabimi i vjetshëm ishte se donim ta vinim për zhavorrin bituminoz, për këtë që po flasim sivjet, ndërsa në ligj, gabimisht u shkrua një produkt tjetër. Kjo ishte e gjitha.

Eduard Shalsi – Qartë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po për zhavorrin bituminoz? Po, vazhdo!

Ilir Beqaj – Irfan, më fal: në cilën kulturë bujqësore përdoret rëra bituminoze?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mirë, pse rrinë ata të bujqësisë? Le të shkojnë në ministri, se kanë punë, kanë punë me IPARD-in. Duhet të shkojnë qark më qark e të prezantojnë IPARD-in. Le të ikin ata. Për çfarë i mban?

Eduard Shalsi – Pse, Ministria e Bujqësisë e prezanton IPARD-in apo QBR-ja?

Ilir Beqaj – Jo, Ministria e Bujqësisë.

Eduard Shalsi – Ashtu, ë?

Ilir Beqaj – QBR-ja e zbaton. Për ta prezantuar e prezanton ministria. janë çdo ditë nëpër qarqe.

Lëri të ikin, se kanë punë.

Eduard Shalsi – S;ka gjë tjetër për bujqësinë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dëgjove? Kanë arsye që qëndrojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka gjë tjetër për bujqësinë?

Aurora Alimadhi – Unë e kuptoj pamundësinë për të adresuar kërkesa shtesë në buxhet, por jemi të detyruar edhe ta prezantojmë. Edhe herën e parë, në prezantimin e buxhetit, ministri e ka adresuar. Jemi të keqfinancuar në projektin e Bankës Botërore. Ia kemi referuar edhe Ministrisë së Financave. Konkretisht, nevojiten 1, 4 miliardë lekë financim i huaj për projektin e burimeve ujore, dhe 470 milionë lekë TVSH. Kjo na e implikon procesin, sepse tashmë i bie të hyjmë në procese prokurimi, duke mos i pasur ato fonde në buxhet. Se si do të adresohet...

Ilir Beqaj – Më fal, po flisni për atë marrëveshjen që kemi miratuar në korrik?

Aurora Alimadhi – Po.

Ilir Beqaj – Patjetër atëherë! Për çfarë e kemi votuar në korrik? S'diskutohet. Na thoni sa është dhe le ta shohë Ministria e Financave, përderisa është marrëveshje e miratuar në Kuvend, në korrik. Ishin ato tri zonat apo jo?

Aurora Alimadhi – Po, po, 23 milionë euro.

Ilir Beqaj – Epo është fakt, është detyrim.

Aurora Alimadhi – Është detyrim në marrëveshje ndërkombëtare.

Ilir Beqaj – Patjetër! Madje ka qenë shtesë, në mos gabohem. Ka qenë shtesë.

Aurora Alimadhi – E kemi prezantuar si kërkesë-shtesë, por jo akomodim brenda për brenda, sepse s'kemi ku ta akomodojmë.

Eduard Shalsi – Dakord jemi! Formuloje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Jo pra, se është për vitin e ardhshëm. Ai është shpenzim korrent, ndërsa këto janë investime. Nuk e bëjmë dot kalimin nga njëri te tjetri, sepse investimet kanë tjetër rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko, më vjen keq tashti!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një marrëveshje e lidhur në parlament, në korrik, s'mund të mos jetë e akomoduar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos ik pa e zgjidhur këtu, në relacion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtesë pra, shtesë.

Të lutem, referoje edhe ligjin e marrëveshjes. Marrëveshja filan, e miratuar në korrik, me detaje, se s'ka kuptim. Mos ik sot, pa e mbaruar atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Tani, të lutem, me dy fjalë: je njohur me propozimin e bizneseve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prezantim: emër, mbiemër, pozicionin e pastaj vazhdo.

Benet Fociro – Benet Fociro, drejtor teknik i akcizës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Qëllimi i propozimit për shtesën e këtij neni në ligj, ka qenë për të përafruar apo barazuar qëndrimin që mban administrata doganore si ndaj prodhuesve vendës, ashtu edhe ndaj importuesve, të cilët përdorin pullat fiskale për produktet që paguajnë me akcizë. Nuk ka pasur ndonjë parashikim për pjesën e importuesve, dhe ky ka qenë qëllim i për ta shtuar si nen.

Mund ta lexoj si ka qenë në variantin e parë dhe si është rregulluar pasi është marrë në konsideratë edhe shqetësimi i bizneseve.

Citojmë nenin 94/1, “Shkeljet në qarkullimin e pullave fiskale”, si ka qenë: “Tepriat ose mangësitë në pullat fiskale, të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë, në porositje, prodhim e lëvizje përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë sa trefishi i detyrimit të akcizës që duhej paguar për produktet e akcizës, të konvertuara në sasi të përkatëse”, sipas parashikimeve në këtë ligj.

Kjo shkon edhe në analogji me parashikimin, se është pothuajse njësoj me prodhuesit vendës që përdorin pulla fiskale.

Eduard Shalsi – Më fal një sekondë, që ta kuptojnë edhe kolegët.

Benet Fociro – Kështu ka qenë.

Eduard Shalsi – Domethënë, problemi ishte midis atyre që importonin dhe atyre që prodhonin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur konstatohej mangësi. Në rast të konstatimit të diferencave të pullave fiskale. Kjo pasi morëm në konsideratë shqetësimin e biznesit. Sepse u bë një pyetje e thjeshtë: nëse do të më mungojë një pullë, jo për fajin tim, a do të penalizohem? Ishte të drejtë, ndaj bëmë rregullimin sipas citimit më poshtë:

“Tepëricat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2 %...”

Pse është fjala për 2 %? Sepse është përdorur e njëjta normë edhe te prodhuesit vendës.

“...të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë, në rastet kur nuk janë depozitues të miratuar përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë sa trefishi i detyrimit të akcizës që duheshin paguar si për produktet e akcizës, të konvertuara në sasi të përkatëse,”

Edhe në konsultë me operatorët doli se nuk i penalizon, sepse të gjithë ata që do të jenë mbi dypërqindëshin i bie të jenë ata që e kanë mendjen për evazion. Në përvojën e tyre, ata nuk e kalojnë këtë dypërqindëshin. Dikush 1 %, dikush 1, 5 %, sipas kategorive të caktuara të produkteve të akcizës, që ata importojnë apo prodhojnë.

Shqetësimi tjetër që kanë është: a do të njihen këto pullat që humbin në gjithë procesin e porositjes. Lëvizjes, mbajtjes, vendosjes dhe importimit të tyre, jo për faj të tyre, pavarësisht atyre?

Jemi menduar dhe e kemi bërë në relacion, që kjo mund të jetë një pjesë që do të trajtohet nga dispozitat ligjore, nuk ka nevojë të vendoset në ligj, por menjëherë pasi të miratohet kjo. do të merremi me të. Kemi përgatitur edhe draftin dhe po fillojmë punën për të mundësuar lehtësimin apo masën se sa do të njihen me vendim të Këshillit të Ministrave këto pullat e humbura, por edhe procedura për njohjen e tyre.

Eduard Shalsi – Qartë!

Benet Fociro – Besoj se këtu penalizohen vetëm subjektet e zeza, po themi, ata që kanë ndërmend të bëjnë evazion apo kontrabandë, ndërsa subjektet e tjera lehtësohen brenda kufijve normalë.

Eduard Shalsi – Në rregull!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakip Suli – Mbase gabohem, po unë për vete nuk jam edhe aq i qartë që në fillimin e trajtimit të problemit, kur the: barazimi mes tyre. Më shqetëson edhe çështja në lidhje me pullat fiskale, që thatë deri në 2 %. Për mua, pulla fiskale është para. Si mund të thuash: humba paratë? Si mund të ketë diferencë prej 1 % apo 2 %? Aq sa ka kushtuar pulla fiskale duhet paguar në detyrimet atje. Mbi atë bëhet taksimi. Si mund të thuash: humba paratë, a thua se humbe pesëmijë lekëshin?

Eduard Shalsi – Ka firo, pra, thotë.

Rakip Suli – Pulla fiskale firo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Kanë të drejtë ato bizneset që janë ankuar. Për çfarë kanë të drejtë? Pullat fiskale blihen, merren këtu në Shqipëri, bëhet eksport doganor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem! Kur shkojnë në një fabrikë birre apo në një fabrikë vere...

Rakip Suli – Unë e di që pulla fiskale është e paketës...

Eduard Shalsi – Po le të mbarojë njëherë!

Vullnet Sinaj – Vetë makineritë që ngjisin këto pulla kanë dëmtime.

Eduard Shalsi – Unë jam i qartë.

Vullet Sinaj – Edhe këtu, brenda në vend, ndodh e njëjta gjë, kështu që si mund të gjobiten trefish? Është gjynah! Ata e kanë paguar një herë. Mjafton pagesa. Mungesa të bëhet shkarkim.

Eduard Shalsi – Qartë!

Beqaj!

Ilir Beqaj – Së pari, Niko, kam një vërejtje. Të paktën kësaj here ishte rasti i tretë, që mbi projektin e sjellë zyrtarisht nga qeveria, ju vetë rivini me një riformulim, i cili vjen nga një shqetësim biznesi, që do të thotë se para se ta çonit në qeveri, nuk e keni shteruar siç duhet pjesën e diskutimeve me biznesin. Se na u bënë tre raste. Për sa kohë që ju reflektoni me të marrë shqetësimin, kjo do të thotë se po krijojmë ca kosto të panevojshme për të gjithë. Jam i bindur se ka sipërmarrës, të cilët nuk kanë fjetur mirë sa ne.

Eduard Shalsi – Jo, jo, ja po ta them unë! Nga dita e hënë e javës së kaluar e deri tani, janë të paktën tridhjetë e tre a tridhjetë e katër mesazhe të numëruara tek unë.

Ilir Beqaj – Kështu krijojmë ca kosto të panevojshme. Nuk po marr vetëm aspektin se unë jam sot në politikë, po edhe në shoqëri krijojmë një klimë të pakëndshme për të gjithë aktorët, e cila pastaj reflektohet dora dorës edhe më gjerë.

Tashti, vetë ju vetë na vini me një formulim, nuk është se bëmë ne ndonjë propozim. Ai shqetësimi, siç erdhi nga një grup, para se t'i drejtohen Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit. Ndërkohë, pse nuk i shteroni me njëri-tjetrin, që e keni një çikë më kollaj? Këtë e kam si vërejtje.

Tashti kam nja dy pyetje. Besoj se këtu është fjala më shumë për lëngjet, jo për cigaren? Sepse kjo ndarja: vendës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, raporti vendës – importues është kryesisht te lëngjet apo jo? Sepse te cigaret s'kemi shumë prodhim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë: praktikisht, po flasim në lidhje me përmasat e problemit, nuk është se kemi shumë prodhim cigaresh në vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qenë një në Librazhd, një gjë e vogël.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga këtu kam një pyetje: në numër pullash, cili është raporti midis atyre që vendosen në vend dhe atyre që shkojnë në import, nëse mund ta keni si informacion, pak a shumë: gjysmë për gjysmë, 25 me 75, 40 me 60?

Nikolin Lera – Në lidhje me produktet, për shembull te produkti i verës jemi 50 me 50. Edhe tek birra në këto nivele jemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kurse te cigarja është vetëm importi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te vera, po themi, përqindja mund të jetë më e madhe.

Ilir Beqaj – Më falni! Ju thatë se deri më sot frot e pullave në prodhim vendës kishin penalitet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kanë pasur penalitet. Përgjashtimi ishte vetëm në import.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U bënë gjashtë a shtatë vjet që funksionon kjo mënyrë apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që kur e mori në koncesion, pesë gjashtë vjet.

Nga sa informacion keni ju, teknologjitë që përdoren për ambalazhim në perëndim, në krahasim me teknologjinë që përdoret në Shqipëri, nga pikëpamja e mekanizimit, çfarë firosh pranojnë?

Benet Fociro - Në rast se i marrim me kategori të ndryshme, ka firma të ndryshme e teknologji të ndryshme, fabrika të ndryshme. Po marrim rastin e cigareve, për shembull...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne kemi vërtetime nga firmat prodhuese, nga kompanitë prodhuese atje, që sasia e tyre është goxha e madhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në përqindje shkon nga 1 % deri në 2 %. Jo më pak se 1 %, po rreth 1-përqindëshit. 2-përqindëshin e kemi vënë vetëm për efekt të penalitetet. Kjo nuk do të thotë se do të vendosim 2 % firo. Ndërkohë po i përgjigjem edhe pyetjes së deputetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, bëhet fjalë vetëm për penalitetet. Nuk nënkupton se ne po i njohim firo.

Rakip Suli – Tashti, në lidhje me atë që kolegu po mundohet të sqarojë, unë njoh mirë ç'është pulla fiskale, por do të doja të thosha pse jam kundër. Jam kundër për dy arsye: në momentin që ne i lëmë hapësira pjesës së doganës, si puna e referencave, si puna e produktit, ne e lëmë në dorë të doganierit, pra nëse do doganieri vë referencë. Nëse s'merr paratë s'vë referencë. Unë jam kundër idesë për të vënë njëpërqindësh e dypërqindësh. Pse? Po flasim për produkte me akcizë, miqtë e mi. Jo më larg se para dy javësh, ne kaluam në parlament një ligj, sipas të cilit s'lejohej përdorimi i pijeve alkoolike nga persona nën moshën 18 vjeç. Nga ana tjetër, sot themi që të heqim dypërqindëshin. Unë për vete jam kundër kësaj. Jam i mendimit të mos lëmë fare hapësirë te njëpërqindëshi apo dypërqindëshi, sepse kështu mbetet në dorë të njeriut. Po puna e referencës? A mund ta implementojë si të dojë apo jo?

Vullnet Sinaj – Ligjërisht ka një rregull dhe një procedurë.

Rakip Suli – Si do të veprohet konkretisht, pra?

Vullnet Sinaj – Nëse ka raste që abuzohet, mbajmë qëndrim.

Rakip Suli – Po pse duhet ta lëmë këtë hapësirë abuzimi?

Vullnet Sinaj – Si kudo.

Eduard Shalsi – Cili është propozimi yt? Ta lëmë siç është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Edhe një herë: nuk po themi t'u falim akcizën. Po themi vetëm për penalitetin. Ne vendosim një kufi midis subjekteve të bardhë, po themi, atyre operatorëve që

kanë ndërmend të punojnë me ligje e rregulla, dhe operatorëve që kanë ndërmend të bëjnë kontrabandë apo prodhime klandestine.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtyre nuk po ua falim atë akcizë, por ky do të marrë penalitet sa trefishi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ndërkohë nuk e kemi çliruar nga detyrimi për të paguar akcizën, aq më tepër që e kemi edhe të garantuar atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk i çliron nga akciza kjo, kështu që po e kupton gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne po ndajmë penalitetet. Sepse na ka ndodhur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë tani, një sekondë! Një e nga një.

Benet Fociro – Dua ta theksoj edhe një herë, se ky nen kjo nuk e çliron nga detyrimi i pagesës së akcizës, deri sa ai të konfirmojë se pullën që ka marrë nën një garanci 100 %, ta kthejë apo ta fusë në procedurat doganore. Detyrimi i akcizës vazhdon. Ne po themi se penaliteti do të jetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Dakord, dakord!

Benet Fociro – Ky nen nuk e çliron nga detyrimi për të paguar akcizën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Dakord me këtë formulim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ju na keni sjellë një propozim për të hequr akcizën e disa artikujve, meqenëse vendet fqinje nuk e kanë, dhe kjo krijon hapësirë për kontrabandë.

Në mos gabo, kjo paketë kishte shtatë ligje, katër prej të cilave vijnë vetëm për të ndërhyrë, meqenëse në zbatim të ligjeve, të dyja administratat fiskale nuk bëjnë detyrën që u ngarkon ligji. Kjo është e para.

E dyta: unë besoj, sidomos pas asaj që ndodhi dje, s'mund t'i fusim shashkat pa akcizë. Bëni si të doni, zbatoni ligjin, forconi kontrollin, por mendoj se nuk është me vend të heqim akcizën e fishekzjarrëve. Nuk flas dot për pilat dhe bateritë, por sa u takon fishekzjarrëve e gjërave të tilla s'jam për heqjen e akcizës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'ka arsye tjetër. Na hyjnë kontrabandë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fishekzjarrët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë kam një pyetje. Normalisht, ka ca sjellje të veçanta të subjekteve tashti në nëntor, që ndodhin gjithmonë kur ne ndryshojmë regjimet fiskale. Kemi folur për atë çështjen e taksës së plastikës. Unë kam informacion se nga dogana e Kakavijës, një tregtar i fuqishëm po fut shumë produkt të gatshëm me zero, që pastaj ta shesë në janar, duke na prishur balancat në tregun e brendshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'e ndalojmë dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ndodh gjithmonë me cigaret.

Kam informacion se po ndodh me makinat. Tashti, në nëntor, po bëhet nami me makina të vjetra, sepse që nga 1 janari do të jenë dhjetëvjeçare. Ju mund t'ju leverdisë, sepse kapni një çikë plan këta dy muaj, e me këtë rast s'e bëni edhe aq të madhe, por gropën e gjashtëmujorit tjetër ju e keni mbi kurriz.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se si mund ta shmangni... Siç vini këtu për të kërkuar gjëra që s'i bëni dot, vriteni mendjen edhe për këtë gjë, se për atë jeni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam reflektuar në lidhje me këtë, dhe i jam bashkuar propozimit të Besnikut, po për të pasur zero sam, kur të vijmë te taksa e ambalazhit, nga 20-40 duhet të shkojmë 15-45.

Eduard Shalsi – Meqenëse erdhëm, e hapëm bisedën, sepse jemi te taksa e ambalazhit.

Ilir Beqaj – A të votojmë njëherë akcizën?

Eduard Shalsi – Do t'i votojmë të gjitha në fund.

Ilir Beqaj – Sa i takon akcizës së fishekzjarrëve, unë jam për të mos e hequr. Nuk e di për pilat, bateritë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një minutë, sa t'ia japim fjalën!

Benet Fociro – Në lidhje me propozimin tonë, dy janë momentet në të cilat jemi bazuar: pritshmëria në rritjen e të ardhurave, ku jam dakord me plotësimin e deputetit, që jo gjithmonë kur s'bëjmë dot punën duhet të bëjmë një ndryshim ligjor. Nga ana tjetër, i referohemi edhe nivelit të taksimit të mallrave në rajon. Ndryshimet e mëdha...

Eduard Shalsi – Luhatjet.

Benet Fociro – Jo ndryshimet nga një vend në tjetrin, janë gjithmonë burim dhe nxitje për një evazion të mundshëm. Edhe rekomandimet nga BE-ja, pasi jemi edhe pjesë e programeve, të marrëveshjeve CEFTA, që këto të barazohen ose të përafrohen. Këto kanë qenë dy arsye.

Eduard Shalsi - Qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Sinaj, ju lutem, mund te flisni pak shpejt.

Vullnet Sinaj- Jam kundër përfaqësuesit të doganës, kur thotë që taksat e rajonit të Ballkanit t'i përafrojmë me tonat. Sa produkte kemi ne që ndryshojnë taksat? Duke filluar që nga sheqeri, vaji, lënda e parë për prodhimin e lëngjeve në Shqipëri, koncentratin e prodhimit të pijeve freskuese e keni me 15% taksën doganore. Kjo është skandaloze. Vini këtu dhe kërkon heqjen e akcizës së fishekzjarrëve. Duhet të vinit për produktet ushqimore dhe jo për këto.

Keni 15% taksën doganore për prodhimin e pijeve freskuese, kur ata për mua janë heronj, që prodhojnë dhe kanë tregje eksporti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Për mua ajo nuk duhet të jetë zero, për shumë arsye. I tha zoti Sinaj, janë lëndë të rrezikshme, kanë një problematikë shumë të madhe në mjedis. Unë nuk e justifikoj dot atë që thoni ju se vendet e rajonit e kanë zero, nuk kanë akcizë, sepse së pari, ky si mall nuk ka ndonjë rëndësi të madhe në buxhetin e shtetit. Nëse nuk ka ndonjë rëndësi të madhe në buxhetin e shtetit, do të them diçka tjetër se ka vende që e kanë ndaluar fare importin e fishekzjarrëve. Ndoshta mund të bëhemi ne pionierë të një politike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, Suedia nuk lejon fare të futen fishekzjarrë, sepse janë lëndë të rrezikshme dhe këtë e raportojnë të gjitha vendet e BE-së. Për shembull, në Spanjë ku kam jetuar vite më parë, ditën që ishin festat thuhej: “U bënë kaq aksidente, u prenë kaq gishta” e të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju po përpiqeni ta justifikoni se mund të vijë kontrabandë. Nëse e ka akcizën zero dhe ajo vjen kontrabandë, nga pikëpamja si fakt: çfarë problemi sjell, përveç asaj që tregon paaftësinë tonë për të kontrolluar kontrabandën? Në aspektin financiar çfarë problemi sjell?

Më mirë e lëmë se akciza të jetë siç është dhe ne do të rrisim performancën e ndalimit të kontrabandës. Për fishekzjarrët unë jam kategorikisht që duhet të jenë. Kanë një impakt në mjedis jashtëzakonisht të rëndë, e theksoj këtë gjë. Për natën e Vitin e Ri, të gjithë

njerëzit që janë të sëmurë nuk duhet të dalin nga shtëpitë, aq e dëmshme është, edhe për njerëzit e shëndetshëm jo më për të sëmurët.

Vullnet Sinaj - Zoti Lera, kam një pyetje: nga sa ju rezulton juve, sa është norma e fitimit të firmave që tregtojnë fishekzjarrë? Me çfarë norme fitimi punojnë ato?

Dua një përgjigje, pasi nga informacioni që kam unë norma e fitimit është trefishi i çmimit të blerjes dhe nuk ka vend për heqjen e akcizës.

Eduard Shalsi - Po, në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani plastika, e kemi ezauruar, e kemi diskutuar, sot jemi 35 me 25, ka një propozim 15 me 45.

Vullnet Sinaj - Nuk e mbyllëm ligjin për fishekzjarrët. Llambat dhe pilat për mendimin tim, duhet të shikohen, mund t'i lëmë mënjatë, mund t'ua heqim, kurse vetëm për fishekzjarrët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta them unë se çfarë ndodh në treg. Llambat, ngaqë Kosova dhe vendet fqinje i kanë pa akcizë vërtet siç thonë përfaqësuesit, ato hyjnë në treg kontrabandë. Ato të lirë, llambat, pilat, bateritë.

Ju duhet të bëni një studim në rast se ia hiqni akcizën vetëm për këtë vit, do të shikoni se sa do të rriten importet dhe sa do të rriten të ardhurat në dogana. Në rast se rritja e importeve dhe të ardhurat në dogana rriten më shumë se vlera e akcizës që jua hoqët atyre, atëherë ia vlen "barra qiranë", në rast se nuk do të rriten, vitin tjetër do t'i riktheni përsëri me akcizë ato.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera - Asnjë vend nuk ka tarifë zero për inputet bujqësore, duhet ta dimë këtë. Kroacia 13%, Rumania 9%, Sllovenia 10%, Polonia 8, Greqia 13%, Italia e ka të diferencuar nga 4-13%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Maqedonia e ka 5%, Mali i Zi 7%. Pra, ne po krijojmë gropa të frikshme në buxhetin e shtetit. Këto duhet t'i themi.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Po ta them miqësisht. Po të na kishit pranuar ne si komision me 6, do të kishte ngelur 6, por nuk na pranuat neve me 6, atëherë jua dha Kryeministri me 0.

Nikolin Lera – Unë teknikien jam, por t'i heqësh buxhetit 1,4 miliardë nga inputet, kur ne nuk e dimë nëse do të ulet çmimi, shto edhe 2,6 miliardë që i shkojnë nëpërmjet skemës së bujikut, janë 40 milionë dollarë për të cilat ne duhet të mendojmë.

Ilir Beqaj – Niko, ti je teknikien, kurse ne politikanë. Kur e tha kryetari i partisë, çfarë kërkon që të themi ne tani.

Eduard Shalsi – Ka folur në cilësinë Kryeministrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Plastika dhe taksat vendore.

Në vijim të diskutimit, jeni dakord me propozimin e Beqajt që t'i lëmë siç ishin taksat vendore ?

I ke parasysh, Niko?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erdhi një shqetësim ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E korrigjojmë këtë gjë me propozime.

E vetmja gjë mbetet plastika. Çfarë do të bëjmë me plastikën?

Niko, kam një pyetje shumë konkrete. Nëse ne konstatojmë brenda 3-mujorit të parë që ...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe 6-mujori i parë?

Disi më të qartë, por jo plotësisht të qartë të vendimmarrjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi pak më të qartë, por jo shumë të qartë për pasojat që do të sjellë një vendimmarrje e tillë. Kemi rënë dakord që nga 25-a dhe 35-a ta zbresim. Në nivelet 15, 45...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, lënga e parë granulat deri më sot e ka pasur 0 lekë, kurse tani do të shkojë 25. Ambalazhi e ka pasur 100 lekë, kurse tani do të bëhet 35 lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

100 lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pipeta 100 lekë.

Si do ta bëjmë?

Nikolin Lera – Unë mendoj që t'i ndajmë.

Eduard Shalsi – Për lëndën e parë po e vendosim për herë të parë. Rezistencën e kemi nga prodhuesit vendas, të cilët nuk e dimë sa janë: 10, 20, 100 apo 200.

Nikolin Lera – Vetë përfaqësuesit e industrisë kanë sjellë të dhëna për 100 milionë euro qarkullim i këtij sektori ose 13 miliardë lekë. Unë kam nxjerrë të gjitha kodet nga QKR-ja dhe tatimet e atyre që merren me përpunim plastike dhe të ardhurat e deklaruara nga ata janë 3,6-4 miliardë lekë. Pra, 3,5 herë më pak ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, po. Për prodhuesit vendas u fol atë ditë. Pra, kemi një deklaram të nivelit 25-30%.

Ilir Beqaj – Mos spekulohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Këtë tregon.

Ilir Beqaj – Ata spekulojnë kur e fryjnë, ti mos spekulohet ...

Nikolin Lera - Po bëj edhe një analizë tjetër, zoti deputet.

Në Shqipëri importohet rreth 20 mijë tonë Granulat në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, do të bëj një llogaritje tjetër.

70% e granulatit përdoret për ambalazh të të gjitha llojeve në Shqipëri. 20 000 tonë x 70% x 100 lekë për kilogramë, buxheti i shtetit duhet të arrijë 1,4 miliardë lekë nga taksa e ambalazhit që është në fuqi sot në Shqipëri. E dini sa ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse në Shqipëri importohen mesatarisht 20 mijë tonë çdo vit.

Ilir Beqaj – Jo vetëm për ambalazh.

Nikolin Lera - 70% e saj shkon për ambalazhe. E ka thënë industria dhe e kemi llogaritur edhe ne në bazë të strukturës së kompanive që kemi të regjistruara. Pra, këto shifra që më plus minus 10% janë të sakta. Taksa e ambalazhit që duhet të gjenerojë kjo industri është 1,4 miliardë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

200 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

1\7-ta.

Nuk mundet që çdo problem të këtij vendi t'ia faturojmë paaftësisë. Këta jemi ne. Pse jemi? Sepse këtë tatimpagues me këtë nivel edukate kemi. Humbet 7-fishi i taksës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si ta mbledhim? Me çfarë ta mbledhim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Beqaj, 400 kontrollorë ka e gjithë Shqipëria dhe ka 100 mijë biznese.

Ilir Beqaj – Niko, kjo gjë bëhet nga zyra. Në vitin 2018 nuk mund të vazhdojmë si në vitin 1995. ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Niko, logjika që përdor ti është që ne të bëjmë disa ligje, kurse ju të rrini rehat atje dhe të mos merremi me njerëzit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të ndërtojmë ligje jo vetëm për të shmangur evazionin, por për të forcuar ekonominë shqiptare. Pastaj do të merremi me evazionin. Ju kemi caktuar juve atje, Ministrinë e Financave, tatim-taksat...

Të digjet i njomi bashkë me të thatin,-thoni ju. Meqenëse bëjnë evazion këta, t'i përfshijmë edhe ata pak prodhues të plastikës që kemi, thoni ju. Në asnjë mënyrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryetar, unë mendoj se duhen ndarë në tre grupe, sepse më parë kanë qenë të ndara në dy grupe: ambalazh plastike, ku futeshin produkte të plastikës që kishin brenda ushqimore, për shembull kos, që është e ambalazhuar me plastikë apo ujë importi që është me plastikë të ambalazhuar, ky quhet ambalazh për mendimin tim, dhe të gjitha ato që vijnë pipeta për prodhimin e brendshëm, që do të përdoren për tregun këtu apo për eksport, plus granulateve, nuk duhet të kenë taksë doganore. Kjo për t'i dhënë mundësi prodhimit vendas të marrë frymë, të prodhojë për Shqipërinë, të mos kemi shumë import dhe të eksportoje, sepse do ta rrisim ekonominë. Atë TVSH që nuk do ta merrni në dogana, do ta merrni te qarkullimi i brendshëm edhe më shumë.

Eduard Shalsi – Te pjesa e eksportit kemi bërë një amendim që kemi rënë dakord. Ai që e merr ...

Vullnet Sinaj – Këtë e bën nëse paguan, kurse unë po them që të mos e paguajnë fare.

Eduard Shalsi – Shifra 70% me 20 mijë tonë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Ta lënë detyrën dhe të shkojnë të tjerë në vend të tyre. Janë në rresht njerëzit për vend pune.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Kjo sasi granulati është importuar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa është numri i subjekteve që prodhojnë ambalazh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Propozimi i Besnikut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera – Llogarisni që ne kemi vendosur taksën vetëm për prodhuesit vendas e ambalazheve dhe këta gjenerojnë 200 milionë lekë, do ta vendosim për të gjithë dhe do të gjenerojnë 400 milionë lekë. Pra, nga shtatëfishi që bënin evazion, do ju marrim edhe 1-fishin e atij 7-fishi. Nuk do jua marrim 200 subjekteve, por 400 subjekteve

Besnik Baraj – Duke pasur parasysh që ne e kemi pasur këtë taksë kur importoheshin 100 lekë për kilogram dhe Komisioni Europian reagonte, unë mendoj që ta ulim në 50 lekë për kilogram. Pra, importi të ketë taksë 50 lekë për kilogramë nga 100 lekë që ishte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë taksë që kishim ne ta ...

Eduard Shalsi – Pra, 100 lekëshi bëhet 50 lekë.

Besnik Baraj – Këtu bëjmë edhe një kompromis me parimin, që i referohemi gjithmonë, që ndotësi paguan. Është një parim që me këtë rast ne kemi bërë një hap mbrapa duke reduktuar kaq shumë. Për mendimin tim ajo duhet të ngelej 100 lekë, por meqenëse kemi reagime, unë mendoj ta lëmë 50 lekë, padyshim duke rritur edhe kapacitetet e atyre që vlerësojnë kur futen në doganë që të mos ketë evazion. Kjo sigurisht ndihmon edhe buxhetin e shtetit për ...

Nga ana tjetër, unë mendoj se, për ato arsye që kemi përmendur këtu, meqenëse ne nuk e bëjmë dot zero, por duke bërë që granulat të jenë 10 lekë për kilogram, ne rrisim bazën e subjekteve që do të paguajnë. Padyshim, kjo do të reflektohet me futje në buxhet rreth 2 miliardë, por të paktën është reale dhe tendenca për ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ishte 1,4 miliardë, ajo që thatë ju,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë është më e vogël, por sidoqoftë ka efektin që ndikon te biznesi vendas duke e stimuluar në raport me ...

Kini parasysh që duke qenë granula në të gjitha vendet e rajonit ...

Nikolin Lera – Granula për ambalazh apo granula për çdolloj gjëje?

Besnik Baraj - Granula për çolloj gjëje.

Të bëhet 10 lekë për kilogram. Duke pasur parasysh që rajoni i ka zero, unë mendoj të jenë 50 lekë dhe 10 lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Unë mendoj që duhet të shpjegojmë konceptin se çfarë quhet ambalazh plastike. Ambalazh plastik quhet ai produkt plastik që vjen nga importi që ka ambalazhuar brenda një produkt tjetër. Të heqim nga kodi i ambalazhit pipetat që janë për t'u kthyer në shishe në Shqipëri dhe janë pjesë e lëndës së parë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... të hiqen nga ambalazhi pipetat dhe granulati. Unë mendoj që taksa për ambalazhin të qëndrojë 100 lekë për kilogramë dhe të përjashtohen si ambalazhe pipetat dhe lënda e parë që është granulati. Kaq kisha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Gjatë diskutimeve, në vlerësimin tim dy janë çështjet e përgjithshme që duhet t'i adresojmë: detyrimet që vijnë nga respektimi i MSA-së dhe i marrëveshjeve të tjera dhe së dyti, mundësitë që ne krijojmë me legjislacion për nxitje evazioni. Këtu merakun më të madh e kam jo të humbja e të ardhurave, por të hapësira që krijon për konkurrencë të pandershëm.

Nuk pajtohem me propozimin e Besnikut për t'i vënë 10 lekë taksë granulatis në prodhim, sepse kjo e disavantazhon prodhimin vendas. Importi i plastmasit të serës nuk do të ketë fare taksë, kurse plastmasin e prodhuar për bujqësi këtu do ta shtrenjojmë edhe më shumë me këtë taksë shtesë që do t'i vëmë. Sipas propozimit të Besnikut, tubi që përdoret për bujqësi do të ketë 0 taksë në import, kurse tubin që prodhohet apo mund të prodhohet në Shqipëri do ta përfitojmë edhe më shumë, sepse po i vëmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ashtu ishte. Unë prandaj pyeta.

Besnik Baraj – Ka një modifikim aty: e gjithë plastika që importohet, të jetë 50 lekë për kilogram.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U bë për të gjithë plastikën, apo jo?

Nuk e di se si u përgjigja, por unë propozova që 35-a të bëhet 50 për të gjithë artikujt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Unë, nisur nga shqetësimet që na ngritën përfaqësuesit e sipërmarrjes që erdhën këtu dhe nga pyetja, që u bëmë, nëse ishin dakord që 25-35-a të bëhet 50, sipas vlerësimit tim përsëri, ata e pranuan llogarinë dhe nuk dekurajohen kundrejt importit, por janë të favorizuar, gjithmonë me prirjen që t'u lëmë një hapësirë për neutralitet nga pikëpamja e të ardhurave që arkëtohen nga tatimet, unë sot propozoj të jetë 15-45. Kam qenë për 20-40-ën, por nga informacionet që kam marrë këto kohë për të zbutur pak efektin që mund të ketë për vitin 2019 prodhimi vendas nga ata që kanë importuar këto 2 muaj dhe mund ta mbushin tregun në 6 muajt e parë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aq sa mund të jetë efekti, do të jetë për prodhimin 3-4-mujor. Mbas 6 muajsh do të fillojë të zbutet. Në vitin e ardhshëm të jemi te 15-45-a. Më pas do të shohim ecurinë e vitit 2019 dhe në vitin 2020 do të shohim nëse do ta ngushtojmë, sepse parashoh që do të kemi presion nga vendet e BE-së, kur të vendosim këtë lloj regjimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Arsyetimi që do të bëjmë është, që ne nuk duam të cenojmë, sidomos eksportin, të cilit vërtet do t'ia rimbursojmë, por vetë kostoja e parasë në 4 muaj nga importi i lëndës së parë deri tek eksporti i prodhimit të gatshëm, plus 2 muaj që i duhen administratës tatimore për të rimbursuar paratë në rastin normal, pra kostoja e parasë në 6 muaj, që e rëndon prodhimin vendas, sidomos kur nxit eksportin, na bën që nga 25-35-a, të shkojmë te 15-45-a.

Faleminderit!

Besnik Baraj – Unë do të thosha, se duke pasur parasysh precedentin e arsyetimit në komisionin tonë, që biznesi të mos ndodhet para të papriturave, të kemi një rritje progresive gjatë viteve. Meqenëse ky vit do të shërbejë si test, unë përsëri ngul këmbë që ajo të jetë 10 dhe më pas, ne të gjykojmë dhe vitin tjetër mund ta bëjmë 15.

Në lidhje me BE-në kemi argumentin, se ndërkaq kemi rezistuar deri tani presionin e BE-së dhe po bëhet një zvogëlim i taksës së ambalazhit nga 100 në 50, gjë që shkon konform kërkesave të BE-së dhe diferenca është 40. Më përpara ka qenë pak më e madhe. Ne e zvogëluam këtë diferencë me tendencën që gjatë viteve, duke parë reagimin e biznesit vendas, të shkojmë duke e ngushtuar gjithmonë e më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Duhet të mendojmë se si do të përgjigjemi, sepse ai mund të thotë se e ke 5 herë më të lartë barrierën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj – Megjithatë, produkti final, pjesa që zë plastikën e ...

Vullnet Sinaj – Unë jam me propozimet e Besnikut, sepse nga 100 lekë do të bjerë në 50 lekë. Pra, ke se si t'i përgjigjesh BE-së.

E dyta, nëse do të rrimë dhe do të presim të na thonë ata: ule...

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Vullnet Sinaj – E fundit, me 10 lekë i japim një frymëmarrje prodhuesit vendas. Nuk dua të futem te abuzimet. Në ç'kuptim? Lënda e parë që futet nga importi, a e ka një kosto? Flas se sa produkt del për një ton apo për një kilogram.

Mbi ç'bazë i kontrollon ti tatimorët, meqë ata abuzuakan kaq shumë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

20%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, 2%, por Niko tha se për këtë mbledhin 5 herë më pak taksa. Si e kontrollon ti si tatimor? Janë disa statistika. Me një kg lëndë të parë prodhon kaq shishe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se ka një analizë kostoje për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Besnik,

E para, është logjika.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dyta, duhet të marrim në konsideratë që të gjitha takimet me biznesin që kemi bërë deri tani, kanë demonstruar edhe një fakt, impaktin që kishte në kosto një masë e tillë. Unë personalisht, e konsiderova, sidomos mbas përgjigjeve të tyre në kontaktet me ta, ku na e pohuan vetë që jo të gjithë e bëjnë. Kjo është arsyeja pse nuk janë të përfaqësuar, sepse është një sektor, ku me sa duket ka evazion, shkalla e të cilit është e ndryshme në biznesmenë të ndryshëm.

Ata, që ndoshta luajnë me pak, ishin dakord në parim edhe me nivelet 20-40 (me sa na thanë mbas mbledhjes). Fakt është që situata në këtë sektor është jashtë kontrollit.

Niko, meraku im është nëse konstatojmë një deformim të tregut, sepse e dimë tashmë që njëri (ai me mjekër), na tregoi aplikimin për zonën e lirë, pasaportën dhe dokumentet, situata duhet monitoruar, brenda 6-mujorit të parë, që të mos shkojmë për të vënë vetulla dhe të heqim sytë, pra ndërhyrja duhet të jetë e shpejtë, pra të mos lejojmë atë që ndodhi me rërën bituminoze, lapsusi për të cilën i ka penalizuar ata për 1 vit.

Këtë këtu, ta shohim. Unë përsëri kam pikëpyetjet e mija.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani a do të kalojmë te propozimet?

Ilir Beqaj – Unë kam edhe një merak. Siç e thashë edhe te imputet, Niko, ne duhet të presim që pas shkurtit të paktën këto duhet të jenë 10% më të lira në të gjithë Shqipërinë, apo jo?

Madje, ajo që tha Besniku: nëse zënë 20 % të kostos, po të shkojë te 50-ta do të zërë 10% të kostos.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, pse po i bëjmë këto ndryshime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, sepse ka konkurrencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu i bie që ata duan ulje dhe nga ana tjetër, nuk na garantojnë...

Eduard Shalsi – Pozicionet janë të qarta.

Ndraxhi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)...

Ilir Beqaj – ...po, mor, po, ka prodhues, por në momentin që vihet një regjim i ri fiskal, ai merret me plastikë, nuk e ka problem fare...

Eduard Shalsi – Më ndiqni pak, se do të kalojmë te miratimi i projektligjit “Për sistemin e taksave vendore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’i kalojmë një nga një?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku është pjesa e...? Atëherë, do të më kujtosh pak nenin që i referohet ndryshimi i propozuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në parim për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin”....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, e kemi miratuar në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ndryshojmë vetëm aneksin nr. 1. Biem dakord me ndryshimet e propozuara nga zoti Beqaj? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ikën.

Vazhdojmë me miratimin nen për nen të projektligjit “Për akcizat”, meqenëse në parim e kemi miratuar.

Neni 1 “Duhani”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

94/1-shi, me propozimin e riformuluar. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Ilir Beqaj – Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po pra, te shtojcat.

Ilir Beqaj – Te shtojcat...

Neni 94/1 ishte për pullën fiskale, për penalitetin edhe në import. Me riformulimin jam dakord.

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Këtu kemi edhe pjesën që fishekzjarrët t'i shtojmë...

Eduard Shalsi – Janë tek anekset.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord?

Ilir Beqaj – Edhe shtojca lidhet me një nen.

(Deputeti Beqaj vazhdon të flasë pa mikrofon)

Është një nen ku kërkohet shtojcë dhe aty bëhet ndërhyrja, te neni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtojca duhet kapur diku.

Neni 8 thotë: shtojca nr. 1 “Mallrat e taksueshëm pa akcizë në Republikën e Shqipërisë”...

Te neni 8 do të bëjmë ndryshim me shtojcën.

Do të bëjmë shtojcën pas titullit. Propozoj që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Te neni 8 thuhet: “Zëvendësohet me shtojcën nr. 1, që bashkëngjitet”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani ne po ndryshojmë modifikimet e shtojcës.

Kalojmë te shtojca.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Alkooli, kafeja, cigarja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Produktet energjetike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faqja 9?

Jo, jo, ndryshimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, tek “E 491-shi”, te faqja 9 thuhet: “Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror...”. Këtu jemi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zhavorr bituminoz, pra, 1 lekë për kilogramë.

Atëherë, në shtojcën nr.1, kodi është E492, zhavorr bituminoz, që është 1 lekë/kilogrami, propozohet 0,5. Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishte më e lehtë për kalkulim, thonë këta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

0,4? Atëherë, nga 0,1 do ta propozojmë me 0,4. Pra, nga 1 në 0,4. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Ilir Beqaj – Vijmë te fishekzjarrët.

Duhet shtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Atëherë, rishtojmë...

Ilir Beqaj – Fishekzjarrët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po pra, rishtojmë vetëm akcizën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për fishekzjarrët do të ndiqet kodi referent që e keni në relacion.

Keni ndonjë gjë tjetër për akcizat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Ka ndonjë gjë tjetër në lidhje me akcizat? Këto keni?

I miratuar të gjitha? Jemi në rregull?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Çfarë kishe, Vullnet? Me shpejtësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – ...gjashtëmujore. A të bëjmë një analizë për këto?

Eduard Shalsi – Patjetër, e mbajmë shënim.

Niko, do ta monitorojmë me shumë kujdes këtë. Nëse do të duhet informacion shtesë nga doganat, duhet *briefing*, ndaj ekipit tënd lërja si detyrë të monitorojë edhe çfarë po ndodh tani.

(Zoti Lera flet pa mikrofon.)

Pastaj, se çfarë mase mund të marrë...

Tani, në lidhje me TVSH-në, këtu kemi inputet, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në parim e kemi miratuar. Kalojmë nën për nën tani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, për pikën e dytë.

Atëherë, te neni 1, më falni, në pikën 7 kemi fjalinë: “Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me autobus (me dhjetë vende ose më shumë)...”. Vetëm motori elektrik është 10%, ndërkohë që shtohet edhe për taksitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Unë propozoj të formulohet: “Autoveturat që përdoren për taksitë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Manjola Merlika – “Si dhe për furnizimin e mjeteve që përdoren për shërbimin e transportit taksitë”...

(Këshilltarët e komisionit dhe deputeti Beqaj flasin pa mikrofon.)

E kisha bërë “mjeteve 4+1”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Mirë, dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe mjetet 8+1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të ketë edhe furgonë elektrikë.

Eduard Shalsi – Atëherë, mos e thuaj 4+1, por e lëmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...për shërbim taksitë.

Dakord, atëherë?

Besnik Baraj – Më falni, një minutë!

A ka impakt kjo, zoti Shalsi, se mos do t’i detyrojnë njerëzit të ndërrojnë taksitë?

(Deputeti Beqaj flet pa mikrofon.)

Ah, në rregull.

Rakip Suli – Ndoshta e dinë më mirë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, por nga e di ai kur e blen nëse është ose jo për taksitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, mor, jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Niko, më dëgjo pak tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakip Suli – A ka hapësira për abuzim, apo nuk ka?

Niko Lera – Patjetër që po.

Rakip Suli – Atë po them edhe unë, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë!

Rakip Suli – Unë të blej taksi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Importimi dhe furnizimi i plehrave kimike, pesticideve, farave dhe fidanëve, neni 62/1 “Importimi dhe furnizimi i plehrave kimike, pesticideve, farave dhe fidanëve që përdoren në bujqësi të klasifikuar me kode katër shifror respektivisht janë furnizime me shkallë 0%”.

Vullnet Sinaj – Për fidanët unë dua të konsultohem me specialistët, sepse ndoshta janë më të mirë fidanët vendas sesa të huajt. Këtu kam një dyshim, sepse tek ulliri na ka ndodhur që ulliri autokton është shumë herë më i mirë se ai që na solli Saliu nga Maroku. Kanë sjellë nga anembanë vende të botës dhe kanë dalë edhe shterp.

Ilir Beqaj – Unë kam një shqetësim. Pse duhet të lëmë jashtë materialin gjenetik shtazor?

Eduard Shalsi – Sepse s’ka qenë objekt diskutimi deri tani.

Ilir Beqaj – Bujqësia dhe blegtoia nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra.

Eduard Shalsi - Me nismë deputeti rezervon të drejtën që të bësh një propozim.

Ilir Beqaj – Unë nuk mund të bëj propozim mbi një propozim që s’e kam formalisht si deputet.

Eduard Shalsi – Mund të bësh nismë pa pasur asnjë propozim.

Ilir Beqaj – Nuk mund të shtoj vetëm materialin gjenetik mbjellës shtazor, kur janë ndryshuar të tjerët.

Eduard Shalsi – Shko te Komisioni i Ekonomisë bëj sugjerim dhe propozim.

Nëse do të vendoset taksa për taksi, do të ketë shteg për abuzim?

Nikolin Lera – Është totalisht shteg për abuzim. Nëse ti thua të përjashtohen automjetet (nuk dëgjohet), sepse duhet të jetë në përputhje me standardin e drejtorisë së

shërbimit të transportit, kush do ta identifikojë këtë automjet, sepse në momentin e importit mund të them se do ta përdor për taksi, por nuk e përdor për taksi dhe e shes?

Ilir Beqaj – Kujt ia shet ti?

Nikolin Lera – Zotit Beqaj.

Ilir Beqaj – Çfarë do të bëj zoti Beqaj me atë makinë?

Nikolin Lera – Do ta përdorë për nevoja personale.

Ilir Beqaj – Sot karikimi bëhet me licencë tek ata që bëjnë transport.

Nikolin Lera – Nuk mund të blesh makinë së qoftë se nuk ke licencën, sepse po e bleve makinën, unë, si bashki, nuk ta jap licencën, sepse e kam të mbyllur punën e licencave.

Ilir Beqaj – Sot në Shqipëri që të karikosh automjete ka një rregull të caktuar dhe ka një licencë të veçantë, sepse është një sistem elektrik i veçantë që ta sjell OSHE-ja dhe ti mund të karikosh. Kjo licencë u jepet atyre që merren me transport, nuk u jepet për në shtëpi. Shqipërisë i duhen edhe 15 vjet që ta ketë në shtëpi karikuesin e makinës elektrike. Pas 15 vjetësh e rishohim prapë nismën. Prandaj, Niko, nuk ka hapësirë për evazion, sepse një individ nuk ka ku e përdor. Mund ta ketë vetëm pronari i autobusëve, i cili ka autobusët dhe mund të ketë edhe pajisjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një deputet e fut sot për vete pa TVSH, por në momentin që bën transaksionin tjetër, nuk të qas te kalimi i pronësisë pa paguar TVSH-në, sepse thotë që mund t’ia shesë dikujt tjetër ai.

Eduard Shalsi – Masa është për të inkurajuar këtë kategori biznesi për të përdorur këto lloj automjete.

A jeni dakord me propozimin e nenit 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në nenin 2 “Lista e makinave bujqësore, furnizimi i makinave bujqësore...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga e konstatove faktin që janë çuditur?

Ilir Beqaj - Mënyra sesi po e ndjekin bisedën tonë.

Eduard Shalsi – Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4, “Përtjashtime të veçanta në import”. Pse këtu propozimi është individual?

A ka diçka për të shtuar?

Nikolin Lera- Kemi përjashtuar nga ligji i TVSH-së ‘kafshët laboratorike, lëndët shtazore, gjeologjike dhe kimike’.

Eduard Shalsi – Në bazë të nenit 4 shtojmë një nen 4/1 në lidhje me shtimin e nenit 62/1 me përmbajtje si vijon: “Importimi furnizimi i plehrave kimikë, pesticideve, farave...”

Ilir Beqaj – Neni që sapo kaluam përjashton nga TVSH-ja lëndët e para për prodhimin farmaceutik, meqenëse prodhimi final është i përjashtuar. Për të qenë i qartë me kolegët, unë kam dorëzuar një amendament që barnat nga furnizimi i përjashtuar, siç janë deri sot, të jenë me TVSH zero.

Eduard Shalsi – Shtojmë nenin 4/1, që është importimi dhe furnizimi i plehrave kimikë, pesticideve, farave dhe fidanëve. Pra, furnizimi me shkallë zero.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ne nuk jemi komision përgjegjës, ne e lëmë me çështje dhe pastaj është Komisioni i Ekonomisë që e akomodon këtë.

Niko, nisur nga ajo që the, unë kam një shqetësim. Bimët i mjekojmë me pesticide, po kafshët që i mjekojmë me ilaçe si i bëhet për TVSH-në?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për taksat kombëtare”.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord me formulimin e propozuar 40/20?

(Diskutime pa mikrofon)

Nikolin Lera – Në qoftë se do ta bëjmë zero, detyrimisht prodhimin e vendit për çdo plastikë do ta bësh njëlloj sa importi.

(Diskutime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Niko, të lutem, kam vetëm një pyetje: bërja 45 e të gjitha importeve joambalazh, pra për të gjitha, çfarë të ardhurash sjellë në buxhet?

Më parë ju thatë rreth 7% grumbullohesh si ambalazh, ne përfshimë edhe tubat plastike, edhe qeset, edhe karriget plastike, edhe materialet elektrike. A keni bërë ndonjë vlerësim sa vijnë të ardhurat në buxhet?

Nikolin Lera – Vlerësimi ynë ka qenë, që, së pari, të ulim tarifat, të zgjerojmë bazën e tatueshme dhe të ruajmë të njëjtin nivel të ardhurash ose diçka më shumë. Pra, ne e kemi parë në gjithanshmëri.

Tani, nëse do e bëjmë nga 35- 40 apo 45 deri në 50 importin, në rregull, por do të rrisësh edhe taksën e tubit plastik që shkon në bujqësi. Ne gjetëm 35-ën që të jetë një nivel i pranueshëm, pra që barra të shpërndahet në mënyrë të saktë. Por problemi tjetër është se në qoftë se e bën 45 apo 50 importin, dhe do të lësh 10 vendin, atë ligj nesër do ta kthejë BE-ja dhe do të çfarë ke bërë kështu.

(Diskutime pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Pse nuk thotë BE-ja pse e ka zero Maqedonia?

Nikolin Lera - Sepse, edhe ne duhet ta vendosim zero edhe importin, edhe vendin. Atëherë, na gjeni ku janë 2 miliardë lekë.

(Diskutime pa mikrofon)

Besnik Baraj – Për mua 2 miliardë është e pamundur, sepse përfshihet e gjithë gama e prodhimeve plastike.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Domethënë në qoftë e kemi 25/35, por le të themi se e kemi 30 kudo, me këtë që thoni i bie që në konsumin e plastikës ambalazhet të vijnë 1/3 në Shqipëri. Pra, e taksoni me 100 dhe arkëtoni 2 miliardë, po ta taksojmë me 30, po arkëtojmë përsëri 2 miliardë. Domethënë, po e zgjerojmë bazën me tri herë. Pra, këto 2/3 janë produkte klasike kurse 1/3 është ambalazhi që ka qenë.

Në qoftë se ne bëjmë këtë gjë, unë besoj se evazoni tek ambalazhi do të bjerë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ti vetë thua që unë në prodhimin vendas kam shumë firo.

Kështu që, këto do t'i rikuperosh.

Nikolin Lera – Cila është skema juaj që do t'i rikuperojë?

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj - Uniformiteti i tarifës.

Nikolin Lera – Sa?

Ilir Beqaj – Le të bëjë 25 apo 35. Unë jam i bindur se evazioni në prodhimin vendas të ambalazhit do të bjerë, sepse ai nuk ka pse të bëjë më arbitrazh fiskal nga ambalazhi i prodhimit, do të rrijë po aty. Kështu që, pajtohemi te 25.

Nikolin Lera – Që?!

Ilir Beqaj – Duhet të mbledhësh më shumë se dy dhe që të rrish te dyshi, mos është më mirë ta kemi 10/30 dhe ti marrësh po aq?

(Diskutime pa mikrofon)

Po, por në shkurt plastmasin e serrës e shtrenjtojnë goxha, sepse ai vetëm plasmas ka.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Si e lamë tani?!

15 me 45?

(Diskutime pa mikrofon)

15 me 40?

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Niko, 15/40, si ta synon 2-miliardshin vjetor?

Nikolin Lera – Mund të mos e synojë, por krijon një problem shumë të madh me diferencimin që krijohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Në rregull, po 15/40.

Eduard Shalsi – A jeni dakord me 15/40?

(Diskutime pa mikrofon)

Jemi te neni 2, pra formulimi për eksportuesit. Ajo për të cilin kemi rënë dakord edhe me ministrinë.

(Diskutime pa mikrofon)

A jeni dakord me formulimin e pikës 8/5? Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Nikolin Lera - Ju më kërkuat skemën e rimbursimit dhe unë ju dhashë formulimin dhe ku duhet.

Ilir Beqaj - Unë thashë që është i përshtatshëm për zbatim.

(Diskutime pa mikrofon)

Nikolin Lera – Po, por ne do ta detajojmë, sepse ajo ka nevojë të detajohet. Si do të cekohet....

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – “Administrata doganore rimbursion shumën e taksës së paguar, rimbursimi mbrohet, sipas mbrojtjes së procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Financave”.

A jeni dakord me këtë propozim?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet!

Neni 3. Nuk kemi ndryshime.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Mineraret e kromit për eksport”, “Përqindja e rentës minerare bëhet 9”, ky është propozimi i qeverisë. Propozimi ynë është që të ndryshojmë nenin 6 dhe të vendosim një ndryshim për rritjen e rentës së kromit jo 9% që në vitin e parë, por respektivisht 7% në vitin 2019, 8% 2020, 9% në vitin 2021. Ndërkohë që ka edhe një propozim tjetër: të mos e bëjmë rritjen, por të themi në vitin 2021 taksa shkon 9%. Janë dy propozime për këtë gjë: njëri është që të ndryshojë dhe të shkojë 21% i shpërndarë në 3 vjet, 7%, 8% dhe 9%, pra 2019, 2020, 2021. Një propozim tjetër është që 9% të fillojë në vitin 2021 që t’i japë kohë.

Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Së pari, kryetar, jam me propozimin për gradualitetin, që të shohim edhe si do të pasqyrohet, sepse kërcimi nga 6% në 9% edhe pas 2 vjetësh nuk është i vogël. Ndërsa lëvizja 6%, 7%, 8%, 9% vit pas vitit... Por po kthehem tek ajo se çfarë u kam sugjeruar kolegeve herën e parë. Unë nuk jam që të fillojë më 1 janar 2019, por më 1 janar 2020. Edhe sot, për një muaj e gjysmë, nga 6% në 7% është një e gjashta e barrës, e cila është 15% dhe nuk është e neglizhueshme. Pra, 7%, 8%, 9% të fillojë më 1 janar 2020 dhe në vitin 2022 të shkojë 9%. I qëndroj gradualitetit dhe jo kërcimit në avancë.

Eduard Shalsi – Kush është dakord me propozimin e zotit Beqaj për nenin 6? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

E miratojmë këtë propozim.

Ilir Beqaj – Kam një merak. Niko, të lutem, dua ndihmë. Kjo 6/9-ta është një mënyrë si e kemi përkthyer ne, por aty është me thyesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thoni dy e treta. Duhet ta shohim pak me kujdes mënyrën e të shprehurit.

(Diskutime pa mikrofon)

Logjikën e di unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolin Lera *(pa mikrofon)* – ...Ne kemi propozuar tani një të tretën. Pra, gjithmonë prodhuesi vendas do të paguajë një të tretën e rentës që paguan ai. Sot e ka një të dytën. Nesër do ta bëjë 7% dhe do të paguajë një të tretën e 7%...

Eduard Shalsi – A jeni dakord?

Ilir Beqaj – Nuk e kemi zgjidhur formulimin.

Vullnet Sinaj – Për pjesën e rentës që kthehet në qeverisjen vendore, te bashkitë e zonave ku janë burimet natyrore, minerale apo naftë. Historia e rentës, me aq sa kam lexuar unë, ka qenë e ndryshme në ligje të ndryshme. Ka filluar me 25% që i kthehej mbrapsht qeverisjes vendore, bashkive apo njësive administrative.

Por në rastin kur vlera e rentës minerare kalonte vlerën e transfertës së pakushtëzuar që i jepte qeveria kësaj komune apo njësie dhe nuk merrte gjë fare. Më vonë, më duket në vitin 2014 është vendosur që vlera e cila që u kalon njësive të qeverisjes vendore, ku ndodhen burimet natyrore, është vetëm 5% e vlerës së rentës.

Pra, është 5% e 6%-shit apo 7%-shit dhe është shumë pak. Nga një informacion që kam marrë në Bashkinë e Selenicës ishin grumbulluar gjithsej për 4 vjet me minierën e bitumit të Selenicës, me minierat e zhavorreve bituminoze, me naftën e Gorishtit 6 milionë lekë të rinj, pra 1 milionë e gjysmë lekë në vit. Unë dua të bëj një propozim për ta ndryshuar kthimin e rentës te njësitë vendore, nga 5%, minimumi 25%.

Nikolin Lera – Ministria e Financave, unë nuk jam kompetent i pjesës buxhetore dhe i pushtetit lokal, por ka një kah për pushtetin lokal që merr një përqindje të caktuar dhe çfarëdolloj elementi, veç këtij financimi, nuk kalon atë përqindje të caktuar. Për këtë duhet të konsultoheni më vonë.

Eduard Shalsi – Ashtu siç Beqaj bëri një propozim për ato të tjerat, mund të bësh një propozim, një iniciativë deputeti.

Vullnet Sinaj – E kam bërë dhe e kam çuar tek Erioni.

Eduard Shalsi – Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për taksat kombëtare”.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.11.2018, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen dhe votimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglangtina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Dritan Bici dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ilir Halilaj – Zëvendësministër i Bujqësisë

Aurora Alimadhi – Sekretare e Përgjithshme

Irfan Tarelli – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Enea Hoti – Drejtor i Përgjithshëm i Rregullatores dhe Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural.

Agron Vata – Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Nikolla Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Kuci – përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Jonida Kaza – përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Doriana Toro – përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Arben Krasniqi – përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Benet Fociro– përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eduard Shalsi – Kalojmë në shqyrtimin nën për nën të buxhetit. E kemi miratuar në parim.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Te programet është edhe riallokimi i fondeve që ramë dakord për Ministrinë e Bujqësisë.

Shumë faleminderit, të nderuar kolegë deputetë!

Javën tjetër nuk do të kemi mbledhje të komisionit.

Ju uroj festa të mbara!

Është një numër i konsiderueshëm ligjesh që duhet të diskutojmë në muajin dhjetor. Do të bëjmë një axhendë nga data 3 dhjetor deri në datën 15 dhjetor, pra janë dy javë që do të ketë mbledhje intensive. Pra, pas seancës nga data 4 deri në datën 20. Kështu që parashikoni që nga data 4 dhjetor deri në datën 20 dhjetor, kur kemi seancën parlamentare, se do të kemi mbledhje intensive.

Edhe një herë, faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA